



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi i Komunës Rahovec

RAHOVEC / ORAHOVAC

Onština Skupština Rahovac / Municipaliti of Rahovec

Nr. i faq./Br. str./No. pg. 20

Nr. i faq./Br. str./No. pg. 20

PROCESVERBAL

Datum/Date 26 / 02 / 2021

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më 29.01.2021, me fillim në ora 10:00. Mbledhjen e kryesoi: Kryesuesi i Kuvendit z. Afrim Dina. Konstatohet se kemi kuorum për mbajtjen e mbledhjes.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni t'iu përshëndes, i nderuar Kryetar i Komunës z. Smajl Latifi, nënkryetar i Komunës z. Fatmir Iska, të nderuar kuvendarë, drejtorë të drejtorive komunale, përfaqësues të mediave dhe ju gjithë të pranishëm! Gjithsesi unë dua të falënderoj Kryetarin e Komunës z. Smajl Latifi i cili me një angazhim dhe përkushtim ka bërë rregullim të sallës që të krijohen kushtet sa më të mira për punë, e po ashtu edhe drejtoreshën e Administratës që është përkujdesur që salla e Kuvendit të duket sa më funksionale.

Për këtë mbledhje sot propozojmë këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,
3. Raporti vjetor i Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2020,
4. Raporti vjetor financiar për vitin 2020,
5. Informatë rreth punës së KKSB-së për gjashtë (6) mbledhjet e vitit 2020,
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës,
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik parcelën P – 71510066 – 00386-1,
8. Raporti i punës i Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2020.

Të nderuar kolegë kuvendarë, e qesim në votim rendin e ditës. Konstatohet se unanimisht aprovohet rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Të nderuar kolegë kuvendarë, procesverbali ju ka ardhë përmes emailit pak me vonë dhe arsyeja ka qenë për shkak të vonësës së audio incizimit nga mediumi Kosova press mirëpo për mbledhjet tjera shpresoj që do të na sjellët me kohë dhe procesverbali do të jetë i gatshëm me kohë. Atëherë nëse nuk ka dikush rreth procesverbalit, e qesim në votim. Konstatohet se unanimisht aprovohet pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve.

Masar Popaj – I nderuar Kryetar, kabinet qeverisës dhe ju kolegë kuvendarë. Sot dua të flas për situatën e vërshimeve në komunën tonë e në veçanti në fshatin Fortesë. I nderuari kryetar dhe ju kabinet qeverisës nuk doja të bëja politikë me këtë situatë shumë të ndjeshme, andaj dua të jem i qartë dhe të mos zgjatem shumë. Të reshurat i dimë dhe që nuk mundemi me i ndalë sepse janë proces natyror po duhet të paktën kullimin të përpiqemi ta drejtojmë. Solidarizohemi me të gjithë të prekurit nga vërshimet e komunës tonë por dua të flas sot për fshatin Fortesë ku jetoj dhe e njoh saktë situatën dhe problemet. Është e vërtetë që janë bërë disa intervenime nga ju por pa rezultat, e di që keni zgjeruar një pjesë të shtratit të lumit saktësisht të pjesa e varrezave ku aty edhe disa ari tokë të familjarëve të mi janë marrë për zgjerim e që është deshtë me ndërhy diku tjetër. Por ne asnjëherë nuk do të kundërshtojmë se a po merreni me këtë gjë sepse është bërë për të mirën e fshatit dhe është gjithçka në rregull. Por, duhet të ndërhyni te pjesët e uzurpuara të cilat kanë ngulfatur shtratin e lumit ndërsa edhe po të jetë edhe pronë private asnjë banor i fshatit tim nuk do të kundërshtonin sepse jemi lodhur nga kjo situatë shqetësuese sepse sa herë bie shi mbliidhemi dhe presim më të keqen. Mund të jenë me qindra e mijëra euro dëme dhe në të mira materiale si dhe ato bujqësore, ku sa herë bie shi mbliidhemi dhe presim më të keqen. Ju kërkoj publikisht të punoni në zgjerimin e shtratit të lumit dhe në largimin e çfarëdo pengese përgjatë rrjedhës së tij e deri te lumi Drin që njëherë e mirë të shpëtojnë banorët e fshatit Fortesë.

Fehmi Cena – Faleminderit kryesues, përshëndetje për kryetarin, nënkryetarin, drejtorët, kolegët këshilltarë dhe gjithë që janë prezent në këtë sallë. Unë kam një pyetje për drejtorin e arsimit për një sqarim lidhur me një konkurs që është hapur me datën 26 të këtij muaji për 8 vende të lira pune siç thuhet për arsim fillor, mirëpo nuk është shumë e qartë pasi nuk ceket se për cilat shkolla është fjala dhe në pjesën që lexon në pjesën e dokumentacionit shkruan 26.02.2021 kurse konkursi është hapur me 26.01.2021, prandaj kërkoj sqarim nga drejtori se si qëndron kjo punë sepse ka krijuar huti tek ata që mendojnë me konkurrua.

Hanalora Hoti – Faleminderit kryesues, përshëndetje për kryetarin, nënkryetarin, kolegë këshilltarë dhe gjithë të pranishmit në sallë. Unë deshta të kyqem në temën që e prek fushën e arsimit, pasi dhuna në shkolla është prej fenomeneve më shqetësuese të shoqërisë sonë, përkunder strategjisë kundër kësaj dukurie, jemi deshmatarë të rasteve të fundit ku nxënësit përfshihen në rrahje përleshje nga më të ndryshme dhe unë desha me pyet drejtorin e arsimit se a ka ndonjë raport që tregon gjendjen e sigurisë në shkollat e komunës tone, pastaj sa funksionon trekëndëshi nxënës- prind -mësimdhënës dhe kisha këkuar që prezenca e policies, vizitat qoftë edhe patrullimet e rregullta të jenë sa më të shpeshta në hapësirat e shkollave tona.

Sali Sallteku – Përshëndetje për kryetarin dhe gjithë të pranishmit në sallë. Unë muajin e kaluar i kam bërë një kërkesë drejtorisë së arsimit por edhe kryetari i komunës ka biseduar me atë dhe nuk është marr asnjë veprim dhe deshta me ditë se çka kanë vepruar deri më tani, a kanë qenë në vendngjarje me gjeodetë për ndonjë matje rreth rrugës të shkollave në Malësi të Vogël. Kështu që kryetari kur e thotë fjalën edhe duhet me i qëndrua mbrapa se më premtoi se do ta kryej shumë shpejtë dhe nuk ka marr asnjë veprim për këtë.

Shqipe Kryeziu – Përshëndetje për të gjithë. Pyetja ime ka të bëjë me drejtorinë komunale të arsimit, a kanë të drejtë task forcat që mos me zbatue udhëzimin administrativ, sa kam njohuri unë që ora mesimore duhet me qenë 30 minuta dhe numri me qenë jo më shumë se 20 nxënës në klasë edhe pa pushim të gjatë.

Ali Zhuniqi – Përshëndetje kryesues, kryetar, drejtor, kolegë kuvendarë dhe gjithë të pranishmë. Në lidhje me vërshimet e fundit që janë bërë në fshatin Fortesë por edhe me gjërë, Masari e ceku për pjesën e Fortesës por mua po me interson në nivel komunal pasi më ka ardh një telefonatë nga drejtori Artan Asllani në lidhje me dal në teren dhe me bo vlerësimin e demëve të ekonomive familjare. Unë e kam një pyetje konkrete lidhje me këtë çështje, se a i keni mbuluar ato që kanë ndodhur nga vërshimet e kaluara për me i bo këto vlerësime

për dëmtimin e ekonomive familjare që me i mbulue prapë, pasi që nëse nuk janë mbuluar herën e kaluar këto dëmtime të ekonomive familjare atëherë cila është logjika që me i mbulua këtë pjesën tjetër.

Fehmi Hoxha – Përshëndetje për kryesuesin, kryetarin, nënkryetarin, drejtorët, kolegë kuvendarë dhe gjithë të pranishmit në sallë. Unë po duhet që çdo muaj me përsërit të njëjtën kërkesë të çështjes rreth rrugës Fahredin Hoxha, kështu që kryetar jeni zotuar vitin e kaluar dhe nuk e keni bërë dhe besoj që tani do ta bëni dhe e falënderoj drejtorin që ka dalë në teren dhe jemi takuar bashkë dhe dua të di se a keni bërë paramasë apo parallogari ose ndonjë projekt se kur do të shpallet tenderi për rregullimin e rrugës Fahredin Hoxha respektivisht kanalizimit fekal, kanalizimit atmosferik dhe kubëzimin, pasi sinqerisht është në qendër të qytetit dhe çdo vërshim bëhet katastrof dhe nuk jetohet prej kundërmimit të kanalizimit.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, përshëndetje për ju, kryetarin, anëtarët e kuvendit komunal, drejtorët përfaqësuesit e mediave, OSBE-së, LMT-së dhe gjithë të pranishmit në sallë. Pyetja ime më tepër është e përsëritur pasi kam kërkuar për zonën e mbrojtur që e kemi të ura e Fshejtë të na sjellët lista e gjithë pronarëve që janë dhe që kanë toka dhe t'i shtohet edhe data se kur ata janë posedues të atyre tokave e sigurisht edhe viti të vendoset aty dhe nuk është sjellur, nga kërkesa ime që kam bërë qysh në fund të vitit të kaluar dhe kërkoj që të kryhet kjo punë sepse kemi dëshirë me ditë këtë punë pasi me vonë do ta kemi për shqyrtim edhe këtë temë dhe kjo është arsyeja se pse e kërkojmë. Një pyetje tjetër që ndoshta nuk është në kohë tash por që me përfaqësues të Shoqërisë Kulturore Artistike në Krushë të Madhe kemi pasur biseda përsëri, pra është fjala për Shtëpinë e Kulturës që është rënuar dhe ajo pjesë që ka mbetur, janë dy apo tri dhoma dhe tash kanë kërkuar që këtë vit kur të bëhet rishikimi i buxhetit me pas mundësi me ju bë të mundshme me i rregullue ato dhoma që me pas mundësi ata me ushtru aktivitetin e tyre kulturor.

Kryetari – Faleminderit kryesues, përshëndetje për anëtarët e kuvendit, drejtorët e drejtorive, përfaqësuesit që e mbikëqyrin zhvillimin e kësaj seance apo kësaj mbledhje të rregullt. Unë do të përpiqem t'i përgjigjem pyetjeve që më janë adresuar mua ndërsa drejtorja e arsimit sigurisht përgjigjet për pyetjet që ju kanë drejtuar drejtorit. Masar Popaj ka ngritur një shqetësim që është real dhe legjitim dhe besoj që jemi në dijeni të gjithë por njeri prej atyre që është në dijeni jam edhe une me ekipin tim, që kemi qenë gjatë atyre ditëve të reshjeve që kanë qenë me vërshime për qytetarët e Fortesës, Sopniqit, Xërxes, Malësisë së Vogël, Çifllakut, Gexhës, Ratkocit, Pataqanit, Brestocit, Celinës, Krushë e Madhe dhe disa lagje në qytetet ku ka pasur shembje muresh pastaj shembje të dheut dhe që të gjithë i dini dhe keni informacione rreth këtyre vërshimeve. Vitin e kaluar kemi ndërhy në Fortesë me pastrim sepse ju e dini kur është lidhur kontrata dhe mundësitë për me vazhdua punën për shkak të kushteve të periudhës së dimrit nuk ka pasur dhe është fat i mirë që ka mbërri me u pastrua shtrati. Po ashtu e dini edhe Masari dhe të gjithë e dinë se ma shumë se kësaj here nuk ka pasur shi dhe prurjet e ujërave edhe nga vija të paplanifikuara që ka hapur edhe shtigje edhe vija të reja e sigurisht edhe sasia e madhe e ujërave që kanë ardhë nga zonat kodrinore si e dini edhe u rritë edhe niveli i ujit të Drinit të Bardhë dhe situata ka qenë shumë serioze. Gjithashtu kemi pasur një gatishmëri të shprehur edhe nga ana e Forcave të armatosura të Kosovës përmes brigadës për evakuim dhe shpëtim dhe mbrojtje dhe ju e dini se kemi evakue edhe njerëz që vërtetë kanë qenë të rrezikuar sidomos ato familje që janë me objekte më të vjetra të banimit dhe kanë qenë të rrezikuar. Pra, kemi intervenua dhe ju e dini se tash kemi kontratë dhe besoj që aty ku është pronë publike do të ofrojmë një zgjidhje dhe do të ndërhyjmë me mjete tonat ligjore edhe do ta zbatojmë kontratën edhe aty ku ka uzurpime apo tejkalime në pronë publike. Normalisht që kemi me kërkuar edhe pronaret privat që me qenë me e dobishme dhe me e qëndrueshme zbatimi i asaj kontrate. Në momentin kur rregullohet koha do të kemi punime në rregullimin e shtratit të lumit që nënkupton zgjatje për Sopniq, zgjatje për Rahovec, pastaj ka ura e Bellajes dhe pastrim të terrenit deri në Rogovë atje. Arsyeja se pse nuk kemi mundur me bo zgjidhje deri tash është se unë po mendoj se Kuvendi i Komunës e dini që ka një kontratë që është nënshkruar në fund të nëntorit dhe ajo kontratë është serioze dhe ne do të kemi përsëri një kontratë të re

sivjet, për thellimin e lumit Dullo që kuvendari Munib Durguti e ka ngritë disa herë dhe vazhdimin e shtratit që do ta lidhim Rahovecin me Fortesën diku me shtrat betoni e diku me hapje por do të kemi një ndërhyrje serioze që së paku të sigurohemi që punët që i kryen shteti por ato që vijnë nga fuqia mbinatyrore s'kemi çfarë të bëjmë. Pastaj edhe asamblisti Ali Zhuniqi ka shtruar pyetje lidhur me këtë temë, vitin e kaluar nuk janë kompenzuar dëmet në ekonomi familjare dhe në amvisëri edhe pse kemi bërë raporte të regjistrimit dhe vlerësimit të dëmeve financiare, mirëpo sivjet është vendos me u dëmshpërblye me shumën 1 milion euro dhe dje na ka ardh vendimi i qeverisë për vërshimet në Kosovë dhe sigurisht që nuk janë të mjaftueshme por do të ketë një perpjekje për me i kompenzue në masë të caktuar në bazë të kërkesave të komunës me një përqindje dhe një standart komunat të cilat kanë pasur telashe me vërshime dhe përmbytje për dëmet në amvisëri. Komuna jonë ka 599,000 euro dëme që kryesisht dëmet janë të përqendruara në fshatin Fortesë por ka edhe ne vendbanime tjera për rreth dhe më pak në qytet, vetëm në amvisëri dhe ekonomi familjare. Tash cila do të jetë e destinuar për komunën tonë gjegjësisht për ata që janë prekur nga këto vërshime nuk e di, prandaj nuk është çudi që vitin e kaluar janë bo raporte mirëpo nuk ka pasur zgjidhje por sivjet ka raporte por pritet me pas zgjidhje pasi ka një vendim të qeverisë. Për sa i takon dëmeve ne bujqësi dhe infrastrukture publike pritet edhe ato me u kompensua sepse edhe për ato ka një fond emergjent në Ministri të Bujqësisë që dëmshpërblehen dëmet në bujqësi nga përmbytjet e tokave bujqësore. Nuk e kemi bërë ende raportin për shkak se ka toka nën ujë dhe ne nuk guxojmë me qu raporte të pasakta dhe deri ka java e parë e shkurtit po besoj që bëhet edhe raporti për dëme në bujqësi dhe ne po shpresojmë që edhe aty do te marrim kompensim për dëmet e shkaktuara për fermerët tanë dhe sa do të jetë vlera e kompensimit, ende nuk e dimë saktë por për amvisëri e dimë sakte se janë ndarë shuma 1 milion euro nga qeveria dhe është vendim për me ju dhanë te goditurve. Prandaj unë i porosis dhe i këshilloj edhe anëtarët e kuvendit kudo që hasin këso takime dhe bashkëbisedojnë me njerëz pasi edhe vitin e kaluar ka pas dëme mirëpo nuk janë kompenzuar dëmet ne amvisëri kurse sivjet pritet me u kompensua edhe këto raporte shpresoj se nuk do të shkojnë dëme, pasi komuna nuk ka mundur asnjëherë me dëmshpërblye për shkak se vlera e dëmit është shume e madhe edhe nuk kemi kapacitete financiare për me i dhanë zgjidhje këtij problemi. Pastaj Sali Sallteku e ngriti një çështje dhe sigurisht që unë ju kam miratuar kërkesën tuaj mirëpo këta ma arsyetuan se duhet me bo kërkesë me shkrim nga Kryetari i Këshillit të fshatit apo Kryesia e fshatit edhe kërkesa është shume e rëndësishme nga anëtarë i Kuvendit të Komunës. Dhe ne vërtet kemi problem me gjeodetë sepse kemi numër te vogël me saktësisht vetëm një gjeodetë e kemi pasi disa kanë dal në pension pastaj nga mungesa e pandemisë dhe po ashtu kemi mungesë të kapaciteteve dhe resurseve humane për me bo këto punë por unë po mendoj se duhet të bëhet kërkesa e kryetarit të fshatit nga Enver Çadraku por deri më tani nuk ka asnjë lëvizje në drejtim të dëmit në atë pronë që ju e keni ngritur si çështje dhe nuk ka me pas pasi nëse është pronë publike sigurisht se ne nuk do ta lejomë me matje apo pa matje pa miratimin e këtij kuvendi nuk do te lejojmë dhe nuk mundet askush me bo asgjë. Te pyetja e parashtuar nga Rasim Fazliu, sigurisht ka të drejtë kur e ka ngritë çështjen e listës se pronarëve dhe cilët janë ata pronarë në zonën e mbrojtur të Ura e Fshejtë. Unë po besoj që për mbledhjen e ardhshme sigurisht se do te vjen si informatë se kush janë pronarët që operojnë në zonën e mbrojtur dhe sigurisht se Zyra e Kuvendit mund te na japin rekomandime edhe pse është krejt informacion zyrtar mirëpo duhet me na ardhë si rekomandim edhe nga sekretaria e kuvendit se dikush e ka ngritë këtë çështje dhe ka kërkuar që me e shtie në rend të ditës dhe menjëherë me kryesuesin sipas ligjit konsultohemi dhe e shtim në rend të ditës dhe ska asnjë problem pasi me shumë është neglizhencë dhe keqkuptim se diçka tjetër. Pastaj tek Shoqëria Kulturore Artistike "Bajram Curri", sigurisht se unë kam dhënë një zotim se do te bëjmë diçka sepse është ansambël me traditë dhe sivjet ndoshta me bartje të mjeteve do të gjejmë pozicionin qysh me hap një mundësi për riparim dhe në momentin kur bëhet në shkurt apo mars bartja e mjeteve dhe unë po besoj që kemi mundësi me rrit fuqinë financiare apo me hap një kod të ri që me bo diçka në atë ndërtesë që ka mbete keq si pasoj e rrënimit

te një pjesë te objektit aty. Gjithashtu e inkurajoj ansamblin Bajram Curri që të vazhdojnë me aktivitete dhe te mos ndalen pasi ka një traditë mbi 40 vjeçare pasi gjithmonë na ka bërë krenar edhe si ansambël jo veç neve por derisa te ju rregullohet hapësira atyre mundemi me ju krijua kushte edhe dikun tjetër që ata me ushtrua aktivitetin e tyre artistik. Pastaj, pyetja e drejtuar nga Fehmi Hoxha, unë besoj që drejtori ju ka përgjigj dhe tash vetëm ju lusë për mirëkuptim pasi tash jemi në dimër dhe asnjë kompani përveç atyre për intervenime emergjente nuk është duke punuar. Ne mundemi me bo disa punë në qytet por operatorët nuk janë duke punuar në teren dhe në momentin që sigurohemi se koha na premton dhe stabilizohet pasi na kemi kontratë por mund te lidhim edhe kontrata te reja dhe mund te aktivizojmë edhe kompani tjera. Po ashtu tash jemi edhe kohë fushatë kështu që nuk dëshiroj me krye punët ashtu pasi edhe ashtu jemi në kushte dimri. Sigurisht që jemi në dijeni rreth problemit që e ka rruga Fahredin Hoxha dhe unë besoj që kemi mundësi me i dhanë zgjidhje këtij problemi por nuk mund të them tash me datë sepse ende jemi në kohë dimri edhe zgjidhje të kësaj natyre dhe probleme që mund t'i ngritin me të drejtë, për shkak se përveç intervenimeve emergjente edhe kujdestarive që po bëhen diçka tjetër nuk po kemi mundësi me bo. Po ashtu disa here po kemi problem me ndriçimin publik që janë të vendosura nëpër shtylla edhe nuk po intervenojnë menjëherë për shkak të kushteve të ftohta atmosferike dhe po hezitojnë me krye punën edhe sigurisht reshjet e shiut kanë ndikuar edhe dëmet që janë shkaktuar në infrastrukturë publike pastaj në ndriçim publik për shkak të problemeve me KEDS-in me mbi ngarkesë dhe na ka shkaktua shumë dëme edhe në ndriçim publik me djegjen e trafave kabllot elektrike edhe plot pajisje tjera për shkak të rrymës ne dobët në shumë zona të komunës tonë. Pra, janë disa probleme që tash nuk po kemi mundësi me ju bo zgjidhje për shkak të periudhës së dimrit dhe nuk po ka shumë aktivitete. Unë ju kisha falënderua për kontributin që keni dhënë në ngritjen e këtyre shqetësimeve dhe po besoj që nuk i kam mbetur borgj dikujt për pyetjet që më janë adresua mua kurse për pyetjet që ju kanë adresuar DKA-së apo dikujt tjetër, mundeni me i lanë edhe në seancën e radhës, pasi kam edhe raportin e punës dhe agjendës së ngjeshur ju kisha kërkuar që ta keni mirëkuptimin nëse më lejohet duhet të shkoj.

Avni Morina – Pershendetje kryesues, kryetar i komunës, kuvendarë të nderuar dhe gjithë të pranishmit. I nderuari Dr. Fehmi Cena bëri një pyetje dhe kerkoj sqarim rreth konkursit të fundit që është hapur në DKA, kështu që unë i them se ka ndryshuar ligji për rekrutimin e stafit mësimor dhe çdo konkurs tani e tutje duhet të hapet një muaj përpara, gjithashtu duhet të shpallet në vegëzen e sistemit informimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore në vegëzen e ministrisë dhe pas një muaji fillon afati i aplikimeve dhe duke u bazuar në këtë ligj në bashkëpunim edhe në Zyrën e Personelit sepse tash çdo konkurs bëhet në bashkëpunim me Zyrën e Personelit dmth e kemi shpallur konkursin dhe në konkurs sipas ligjit të ri nuk shkruhet dhe nuk guxon të shkruhet emri i shkollës, por, vetëm numri i pozitave sipas programeve. Ne sipas planifikimit i kemi pasur 8 pozita të cilat mund te jenë te lira deri në fund te vitit 2021 dhe kjo nenkupton që keta 8 mësimdhënës të ri që i pranojmë nuk do te thotë që fillojnë punën ditën kur shpallen rezultatet por mund të vendosen nëpër vendet e punës sipas listës së pritjes dhe nevojave që ka DKA-ja nëpër shkolla. Pra kjo është rekomandim në bazë të ligjit për rekrutimin e stafit mësimor. Pastaj pyetjen e parashtruar nga Hanalora Hoti rreth dhunes në shkolla dhe gjendjen e sigurisë. Ne kemi raporte te rregullta kur ndodh ndonjë incident dhe sa për informim që DKA-ja dhe shkollat kanë per detyrë që te kujdesen për sigurinë në objekte shkollore dhe në oborret e shkollave ndërsa për incidentet që mund të ndodhin jashtë oborrit të shkollave, në stacion të autobusëve, apo në autobus, apo dikun tjetër ne nuk jemi pergjegjës dhe për këtë arsye ne kemi pasur nje takim dje me drejtorët e shkollave dhe me këshillat e prindërve dhe me përfaqësuesit e stacionit policor ne Rahovec ku kemi aprovuar kërkesën edhe të stacionit policor që të fillojmë me realizimin e një plani operativ për sigurinë ne shkolla në komunën tonë. Pastaj te pyetja e parashtruar nga Shqipja rreth kohëzgjatjes se orëve mësimore, në takimin e djeshëm që kemi pasur e kemi përcjellë rekomandimin që kemi marr nga ministria e arsimit pasi ju jeni vetë punëtorë e arsimit dhe nuk e di a keni kontaktuar me drejtorin e shkollës, kështu që ne dje ju kemi dhënë disa

rekomandime ku klasat që kanë qenë të ndara në grupe që kanë pasur deri 20 nxënës t'i bashkojmë ndërsa nëse ka hapësirë të mjaftueshme nëpër klasa, për shkak se mësimdhënësve ju binte ka dy herë të japin mësim dhe të realizojnë normë të dyfishtë më të madhe se sa që e kanë të paraparë me kontratë dhe kemi pasur kërkesë gjithashtu rekomandimi edhe i ministrit të arsimit ka qenë që në klasat ku ka numër të vogël të nxënësve të zgjatet ora mësimore deri në 40 minuta ndërsa në klasat e mëdha që janë, mbi 28 nxënës e që janë të ndara në grupe të vazhdohet me 30 minuta. Pra këto rekomandime ju kemi dhënë dhe drejtorëve të shkollave dhe ata fillojnë me i zbatua. Task forcat e shkollës i zbatojnë vendimet e task forcës komunale që është në nivel të DKA-së, kështu që ata vet nuk marrin vendime pasi ata konsultohen me ne dhe pastaj i zbatojnë vendimet.

Sali Sallteku – Atë që e tha kryetari me herët, unë mendoj se nuk është e qëndrueshme pasi oborri i shkollës është i përcaktuar sipas matjeve dhe është në kuadër të drejtorisë së arsimit, dhe nuk ka lidhje me kërkesën nga kryetari i këshillit pasi këtë duhet ta kryej drejtoria e arsimit dhe për këtë kam marr edhe premtim nga drejtori i arsimit.

Kryesuesi – Faleminderit shumë të nderuar kolegë kuvendarë, kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

2. Raporti vjetor i Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2020.

Kryetari – Unë para juve e kam paraqitur një raport të punës i cili përmban synimet, objektivat, prioritetet, aktivitetet, sfidat dhe arritjet dhe natyrisht edhe të metat që e kanë karakterizuar komunën tonë në vitin 2020. Gjithashtu mund të ju them që komuna jonë ka tejkaluar planin e të hyrave të rregullta komunale në masën mbi 102% dhe bashkë me të hyrat e jashtëzakonshme gjobat në trafik, gjobat nga gjykata dhe të hyra tjera që hynë në kuadrin e të hyrave të jashtëzakonshme ka mbërri një tejkalim i të hyrave në masën 109%, pra është një realizim i të hyrave me tejkalim të planit dhe do të shihni kur të bëhet bartja e të hyrave do të shihni edhe tejkalimin nga plani i të hyrave. Realizimi i buxhetit për vitin 2020 po ashtu është një pozicion që komunën tonë e bëjnë mu ndje mirë në masën 98%, pra nuk kemi teprica apo suficite dhe shpenzimi i buxhetit është bërë me një standard që është i kërkueshëm dhe që vlerësohet nga monitoruesit e Ministrisë së Pushtetit Lokal por edhe nga auditorët dhe organizatat tjera nëse dojnë me vlerësua komunën e Rahovecit për me ja dhanë ndonjë grant. Komuna e Rahovecit në vitin 2020, nga 38 komuna, është komuna me transparente në Republikën e Kosovës dhe kjo i bën nder komunës tonë sigurisht kuvendit dhe ekzekutivit edhe qytetareve pasi kemi marr vlerësime pozitive sa i takon transparencës komunale llogaridhënies dhe unë i falënderoj të gjithë ata që janë kujdes që nga ju si anëtarë të kuvendit, bashkëpunëtorëve të mi po ashtu edhe Zyrën për Informim dhe plotë të tjerë që vërtet është vlerësim i mirë pasi nuk ka kurrëgjë që nuk del në publik dhe krejt ato standartet e kërkuara ne i kemi respektuar. Komuna jonë po ashtu gjatë vitit 2020 ka mbërri me pas një vlerësim tepër pozitiv edhe sa i takon përfomances komunale sa i takon qeverisjes së mirë, pasi diku thuhet e dyta kurse dikun thuhet e treta pasi janë dy lloje vlerësimesh, pra te dytë jemi për performancë kurse te tretë për grant, që jemi shpërblye me një grant prej 655,000 euro dhe shpresojmë që do ta merr drejtimin edhe ai grant, pasi ka pasur disa vështirësi dhe sfida për shkak të ankesave që i kanë bërë disa komuna por unë shpresoj që ato mjete ku marrin pjesë në monitorim edhe disa ambasada të huaja bashk me MAPL-në do të ju shpërblehen dhe do të ju jepen komunave për nevojat të investimeve publike në përputhje me ato qysh ata i kanë vlerësuar komunat vetë. Po ashtu ne kemi edhe arritje në vitin 2020 dhe unë besoj që sa i takon vlerësimeve rekomandimeve apo konkluzave që do të nxjerr raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit do të vlerësohemi pak më mirë e sigurisht që do të kemi edhe të meta por do të kujdesemi që edhe ato të meta që ata i kanë evidentuar në vitin 2019 nuk do t'i kemi në vitin 2020. Pra në vitin 2020 e kemi pasur vitin më të rëndë në historinë e qeverisjes për shkak se jemi përball bashkë me një armik të padukshëm COVID-19, ku kemi pasur shumë angazhime edhe si komunë edhe stafi i kryetarit edhe shëndetësia inspektorët edhe policia. Pra, prej muajit mars e tutje kemi pasur situatë të jashtëzakonshme edhe nga pikëpamja e përpjekjeve tona për përballimin e situatës së krijuar me Covid-19, ku kemi 60 raste me fatalitet pastaj 445 të shëruar dhe mbi 100

raste aktive ende dhe pandemia ende e kësaj dite vazhdon dhe shpresojmë që efekti i virusit të jetë më i dobët dhe ta perfundojmë sa me shpejt pandeminë. Për kundër faktit që kemi qenë me pandeminë bashkë, ne nuk i kemi ndërprerë aktivitetet në sferën e investimeve publike në gjithë sektorët ku kemi pasur edhe investime kapitale, pra, kemi zbatuar projekte edhe në fushën e investimeve kapitale pastaj në trajtimin ujërave të zeza në rrugë fushore etj. Po ashtu, i kemi kushtuar vëmendje bujqësisë gjithashtu i kemi kushtuar vëmendje edhe dëmëve që kanë prodhuar fatkeqësitë elementare natyrore që kemi pasur vërshime vitin e kaluar të përmytjeve të tokave bujqesore dhe kemi marrë një dëmshperblim prej 651,000 eurove dhe është komuna e parë që ka marrë më së shumti dhe natyrisht është më e dëmtuara në bujqësi. Kemi pasur aktivitete edhe në shkolla edhe pse me ndërprerje kuptohet duke i funksionalizuar dhe duke i respektuar masat anti covid dhe sigurisht ju e dini se në fillim të këtij muaji jemi shpallur nga dy organizata që e kanë mbikqyr aspektin e respektimit të masave anticovid komuna e parë në respektin e masave anticovid nëpër shkolla, që realisht është një vlerësim që ata i kanë monitorue dhe me siguri nxënësit tanë. Drejtorët e shkollave i kanë parë se po respektohen masat anti covid pastaj bëhet matja e temperature, e vendosja e maskave dhe kemi marrë vlerësim dhe sigurisht për neve ka qenë një befasi e mirë që jemi shpallur komuna më e mirë që jemi shpallur në respektim të masave anticovid nëpër shkolla dhe unë e falënderoj task forcën në nivel të DKA-së dhe task forcën në nivel të secilës shkollë që ka bërë punën e vet dhe ne nuk jemi dal keq dhe infeksioni nuk ka mbërri me u përhap siç është përhapur nëpër shkolla tjera të mesimdhënësit, të nxënësit, kështu që gjendjen e kemi stabile nëpër shkolla. Sigurisht që ne kemi edhe dobësitë tona pasi kemi mungesë të puntorëve dhe e dini se ligji i ri për zyrtar publik e ka pamundësuar rekrutimin e resurseve humane në administratë dhe kemi shumë punëtor që kanë dal në pension dhe nuk kemi pasur mundësi me i zëvendësuar. Pra, kemi pasur sfida gjatë gjithë vitit jo vetëm ne si komunë por e gjithë administrata publike për shkak të hyrjes në fuqi të ligjit të ri për zyrtar publik dhe mënyra e rekrutimit siç e tha edhe më herët drejtori Avni Morina ka ndryshuar tërësisht edhe në arsim, në shëndetësi e sigurisht edhe në administratë. Kështu që ato vështirësi që i përmenda në raport pasi kemi vetëm një gjeodet që punon dhe nuk kemi të drejtë me marrë ndonjë tjetër kështu që edhe atë që e kemi e ka një moshë dhe kemi pasur edhe kufizime në reduktim të stafit për shkak të pandemisë, pra, kemi pasur vështirësi në plot matje që është deshtë me i bo në plotë terene dhe me plotësua shumë kërkesa që kanë nevojë edhe institucionet edhe qytetarët në sektorët e caktuara. Po ashtu, kemi pasur vështirësi edhe në shumë gjëra tjera pasi nuk kemi pasur të drejtë edhe në shërbimin e kontratave të veçanta për shkak të efektit që ka prodhuar ligji i ri i zyrtarëve publik dhe tash ka fillue me u bllokue situata por ende jemi keq me staf të punëtorëve. Pasi unë nuk jam keq me drejtorët sepse i kam 12 drejtorë edhe me punëtorët e Zyrës së Kryetarit por në shumë sektorë kemi mungesa p.sh. në drejtorinë e inspeksionit një inspektor ka dal në pension dhe një inspektor ka vdekur dhe ne nuk kemi pasur mundësi me rekrutue dikënd tjetër dhe nuk kemi pasur mundësi me marrë dikënd me shërbime të veçanta që janë me afat të kufizuar. Por, përkundër kësaj këtyre vështirësive dhe të metave që mund t'i kemi si qeverisje secili edhe unë si kryetar, unë mendoj se është demonstrue një vullnet i mirë i përbashkët i gjithë stafit, i drejtorëve, i bashkëpunorëve të mi por edhe i kuvendit që me i krye punët që neve na takojnë si komunë, që realisht kemi marrë edhe vlerësime pasi nuk jemi komunë e harruar as nga niveli qendror e as donatorët e jashtëm dhe kemi mbërri me i bindë se kemi qeverisje mirë sigurisht edhe në bashkëpunim me ju kuvendarë të nderuar. Pra jemi përpjek me qenë shumë korrekt sa kemi dit dhe aq sa kemi mundur në zbatimin e ligjit dhe në arritjen e objektivave që i kemi vendos në planin tonë të punës dhe që i kemi diskutua në 12 mbledhjet e kuvendit të komunës. Pra, edhe nga kjo pikpamje ne kemi plotësue standarte që kemi mbajtur 6 mbledhje të KKS-së që është standart, kemi mbajtur 12 mbledhje të rregullta të kuvendit të komunës që është standart dhe gjithashtu një mbledhje e jashtëzakonshme, ju ndoshta edhe nuk e dini që ka komuna që nuk kanë mundur me i bo as 6 mbledhje. Pra i kemi realizuar disa standarte që neve na japin një mundësi që zotimet tona që mund të i japim edhe për këtë vit me qenë valide reale edhe të mundshme

edhe gjithashtu me u zbatue. Unë i falenderoj anëtarët kuvendit të komunës për kontributin që pavarësisht ndonjë përplasjeje që kemi mundur me pas gjat vitit 2020 e cila është krejt e natyrshme, por, sigurisht që edhe ne jemi përpjekur që mos me rae në ndonjë pozicion që me injorue dikënd apo ndonjë kërkesë, kështu që jemi përpjekë që çdo shqetësim që e ka ngritur dikush në Kuvend me u mundue me i dhanë zgjidhje aq sa kemi pasur mundesi, të vetëdijshëm që jo të gjitha problemet mund të trajtohen përnjëherë dhe jo të gjitha zgjidhjet mund të arrihen shpejt dhe të vetëdijshëm që kemi pasur shkurtime buxhetore nga qeveria Kurti për shkak të pandemisë dhe kanë vazhduar me qeverinë Hoti poashtu për shkak të pandemisë dhe të vetëdijshëm poashtu që megjithatë që krejt ato që kemi pasur mundësi buxhetore kemi mbërri me shpenzue drejt dhe pa ndonjë shkelje ligjore. Gjithashtu jemi përpjekur me i ikë keqklasifikimeve maksimalisht edhe në realizimin dhe shpenzimin e buxhetit ndarje të granteve pastaj në financimin e operatorëve edhe krejt ata që kanë marrëdhënie kontraktuale apo marrëdhënie me komunën edhe besoj që jemi tregue të vëmendshëm edhe falë përkushtimit edhe angazhimit që keni pasur ju. Natyrisht që nuk jemi shumë të kënaqur dhe ne do të përpiqemi që të anagazhohemi dhe punojmë edhe gjatë këtij viti, sigurisht që ka plot njerëz që kanë mendime dhe percaktime të ndryshme por ne do te mundohemi të bëjmë punën tonë për shkak se e ndjejmë te të obligueshme me raportue sepse edhe ky raport është i publikuar dhe për secilën drejtori është i publikuar në webfaqe dhe version i zgjeruar i raportit mund të shihet aty. Kështu që nese e marrim çdo kërkesë për qasje në dokumente publike është plotësuar brenda afatit edhe unë jam shumë i kënaqur që kemi mbërri me kapacitetet tona me deshmua se administrata komunale dhe qeverisja komunale është funksionale dhe i përgjigjet me afat secilit që ka një ide apo kërkesë apo propozim që po bëhet në këtë komunë. Po ashtu e kemi deshmuar edhe gjatë vitit 2020 se jemi të hapur për të gjithë, edhe për policinë; e krimeve të rënda pastaj për organizatat jo qeveritare, auditorët e jashtëm edhe për çdo mekanizëm që ka mendue se mund të i shërbej qoftë për monitorue komunën e Rahovecit apo edhe me dënue komunën e Rahovecit kur ka ndonjë shkelje apo shmangie apo gabim që duhet me u evidentue. Mendoj se komuna ka stabilitet financiar por kemi një problem edhe do te kemi edhe ne te ardhmen problem me shujtat që janë duke i kerkuar mesim dhënesit sipas kontrates kolektive edhe sigurisht që do te fillojn me kerkuar sipas kontrates kolektive dhe realisht komuna rahovecit do te jetë ne suate te rend nese nuk mbërrin komunat e kosoves me i dhanë epilog pozitiv që këtë barrë të pergjegjësisë me marr ministria e arsimit ministria e shendetësisë e respektivisht ministria e Financave apo qeveria e Kosoves sepse ata e kanë nenshkure kontratën kolektive dhe do të ishte mire që mos me na goditë që mos me prek buxhetin e komunave edhe pse jemi të vetëdijshëm se sipas kontratës kolektive sigurisht që kanë të drejtë atë ju takon. Komunës se Rahovecit kjo i kushton gati 2 milion euro dhe kjo do të ishte fatale për buxhetin e komunës kështu që do të shohim se si do veprojnë komunat tjera pasi edhe duhet me pas mirkuptimin pasi qeveritaret nenshkruajshin marrveshje kolektive kurse barra shkon te komunat që duhet te ju përmbahen, pasi rreth pagave jubilarë diqka kemi arrit me bo mirpo rreth shujtave kemi telashe për shkak se kosto financiare e krejt ketyre pagesave është e lartë dhe shpresojm që edhe gjykata që mos me vendos shpejt sepse do të kishim shume problem pastaj.

Florida Bajraktari – Raportin e punës se kryetarit e kam lexuar dhe e kam analizuar dhe mendoj që kryetari është vonuar shume ne hartimin e planit zhvillimor komunal dhe te hartës zonale, pasi qysh moti keni thënë se është gati mirëpo nuk e sollët ne kuvend. Pasi nuk është e mjaftueshme që thoni se ministria e ekonomisë dhe ambientit pritët te i japin pëlqimin. Kështu që duhet te jeni me shume insistues ne ministrinë përkatëse që te japin pëlqimin që ti hapet rruga e shqyrtimit publik e pastaj te vjen sa me shpejt ne kuvend për aprovim. Pastaj tek faqe 14 tek njësia e auditimit te brendshëm, që ju ka raportuar për punën e vet që i ka kryer 9 auditime për vitin 2020 por ju kryetar i nderuar nuk na keni informuar për punën e tyre, edhe këtu ne raportin tuaj që na keni sjellë nuk ka shume te dhëna për punën e njësies se auditimit te brendshëm se a është bërë auditimi për vitin 2020 apo për vitet paraprake, sepse ne raportin e fundit te auditorit te përgjithshëm ka pasur vërejtje se

njësia e auditimit të brendshëm shumicën e auditimeve i ka bërë të viteve të mëparshme e jo të viteve të fundit. Po ashtu tek faqe 24, tek drejtoria e shëndetësisë fare nuk e keni cekur mosfunksionimin e qendrës së dializës. Nga qeverisja e kaluar objekti ka qenë i gatshëm dhe u bënë 3 vite që po qeverisni dhe jeni në vitin e katërt dhe ende nuk e keni funksionalizuar repartin e hemodializes që është aq i nevojshëm për qytetaret që kanë nevojë për këtë lloje të shërbimit.

Kryetari – Faleminderit znj. Bajraktari, raportin për secilën drejtori e ka të publikuar në webfaqe ndërsa tash e kemi edhe vlerësimin e punëtoreve, kështu që të them të drejtën nuk do të i vlerësoj me notë maksimale auditorët për shkak jo të mos kryerjes së punës së tyre por edhe unë nuk jam shumë i kënaqur me punën që e bëjnë auditorët e brendshëm. Ne i kemi 9 raportet dhe ata kanë një plan vjetor dhe një strategji vjetore e cila miratohet në kuvend. Sipas rekomandimit të njësisë kombëtare të auditorit të jashtëm, ata nuk mund të auditojnë diçka për vitet paraprake por insistimi është me auditue ajo që ndodh sivjet dhe me një afat të kufizuar p.sh. 9 muhori i parë i vitit 2020 nuk mundet mu nxjerr raporti i auditimit financiar për vitin 2020 të drejtorisë së financave për shkak se pas 15 janarit të vitit të ardhshëm del raporti i barazimit të pasqyrave financiare. Kështu që unë mendoj se ata e kanë krye punën në përputhje me rekomandimet e zyrës kombëtare të auditimit sepse tani kanë vendos objektiva tjera në përputhje me nevojën e zbatimit të atij rekomandimi. Sa i takon qendrës së hemodializes në Rahovec, tash nuk po dua me bo politikë dhe as nuk mënoj asnjëherë për këtë. Qendra e hemodializes në Rahovec nuk ka mundur me u hap as në qeverisjen e kaluar dhe as në qeverisjen që tash jam unë, për arsye siçi dini edhe ju Floridë, pasi është kompetencë e ministrisë së shëndetësisë së Republikës së Kosovës pastaj kompetencë e spitalit rajonal të Prizrenit dhe eventualisht ata mund me ja kalua spitalit rajonal të Gjakovës, por ajo që është kompetencë e komunës së Rahovecit e kemi krye menjëherë dhe në njëfarë mënyre në kohën e qeverisjes Vehapi edhe atëherë u krye. Pra ideja është që pavarësisht që dikush kërkon me bart përgjegjësinë të komuna e Rahovecit, që edhe tani e them publikisht që në momentin ata e bëjnë gati dhe marrin vendimin që në hapë pasi në edhe ashtu jemi gati pasi kemi kërkuar edhe e kërkojmë edhe sot e kësaj dite, pasi pajisjet janë në rregull aparaturat janë në rregull, pra aspektet teknike që na kanë kërkuar i kemi kërkuar krejt si komunë dhe se kur do ta marrin vendimin ata fatkeqësisht nuk e di, pasi edhe ata thonë se do ta hapim edhe ashtu kanë tentuar në vitin 2020 me hapë vetëm për pandemi dhe në nuk e kemi lejuar për shkak se në nuk mund të ju themi pacientëve me hemodialize deri sa të kryhet pandemia mundeni me ardh pacientë nga komuna e Rahovecit, Suharekës Malisheves që me i marr shërbimet mirëpo pastaj në momentin që kryhet pandemia prap duhet të i merrni aty ku i keni marr me përpara. Kështu që unë nuk kam pranuar kështu dhe e kam fituar betejën me Ministrin Vitija mirpo tash nuk ka me veprime tjera që po ashtu ka qenë edhe z. Zemaj që prap ja kemi përsërit kërkesat dhe nuk ka pasur me veprime konkrete nga ana e qeverisë së Kosovës për hapjen e repartit dhe funksionalizimin e repartit të hemodializes. Sa i takon PZHK-së dhe hartës zonale, unë po besoj që ata që janë me të informuar e din se plani zhvillimor është në Ministrinë e Ekonomisë dhe ambientit dhe atje është në fazën e shqyrtimit dhe trajtimit dhe marrjes së një përgjigjeje. Unë do ta shikoj edhe njëher afatin sepse ata kanë një afat që duhet me dhanë përgjigjeje. Se a duhet me u shërbye me atë heshtjen administrative apo jo, mirëpo unë do të i drejtohem prapë dhe e di që PZHK-ja është gati por harta zonale nuk mundet të jetë gati formalisht pa përfunduar PZHK-ja dhe po besoj që përvoja ime në qeverisje nuk është shumë e gjatë por e Fehmies është me e gjatë dhe e din por sigurisht edhe shumë të tjerëve. Pra dy dokumentet nuk munden përnjëherë sepse harta zonale e ka kuptimin e saktësimin të asaj që është në PZHK. Ne pop e presim përgjigjen nga Minsitria e Ekonomisë dhe e ambientit dhe kjo nuk është fare përgjegjësi e kryetarit të Komunës, mirëpo në momentin kur të kthehet nga atje atëherë e shohim se çka mund të bëjmë. Pra në sa i takon pjesës tonë e kemi dërguar pasi kemi pasur kontratë e po ashtu edhe me hartën zonale jemi afruar bukur shumë dhe në momentin kur kjo merr epilog atëherë edhe ai tjetri dokument është gati dhe me siguri do të jetë gati për këto procedura dhe për miratim në kuvend të

komunës ne momentin kur te i vjen radha. Ne kemi pasur dëshirë qysh ne vitin 2020 që gjithashtu edhe unë kam menduar se nuk duhet me u vonue por ndoshta edhe situata e tillë e ka krijuar pasi u dasht me i bo disa debate publike pastaj gjendja e pandemisë dhe sigurisht që është e vërtetë se jemi vonuar pasi edhe ne vlersimet e performances nuk kemi vlersime as ne PZHK e as ne hartë zonale pasi edhe me herët nuk i kemi pasur. Mirëpo meqenëse po bëhet fjalë për hartimin e dy dokumenteve te para që skanë qenë dikur, pasi ka qenë një PZHK e vjetër që u krye ne vitin 2013 dhe ne momentin që u dal ligji i ri atëherë u kërkuar proces i ri për PZHK të re e po ashtu edhe hartën zonale e ka paraparë ligji dhe mirë është që kemi mbërri me hyje ne proces sepse edhe ju e dini edhe ne kohen e qeverisjes se kaluar 3 apo 4 herë ka dështuar edhe tenderi pasi ka shume mirëpo mirë që është mbërri një kontratë dhe ata kanë vazhduar punën dhe jemi gati ne përfundim te punës, por nuk varet nga ne PZHK por varet prej Ministrisë. Sigurisht që kam bërë shume presion rreth kësaj pasi kam biseduar me Ministrin pastaj sekretarin permanent pasi nuk do te thotë që kanë shumë te interesuar rreth kësaj për shkak se arsyetimet janë shume te thjeshta duke u arsyetuar se nuk punon departamenti pastaj stafi është i reduktuar pandemia kështu që ne do të kishim vonesa të paarsyeshme nëse nuk do te intervenoja për këtë unë direkt si kryetar. Unë jam i hapur për me dhanë përgjigje pasi raporti është i kryetarit të komunës, natyrisht se nuk votohet në kuvend dhe nuk prodhon efekte juridike, keni te drejtë plotësisht me dhanë vërejtje sugjerime propozime pastaj për mundësin që keni mundur me punua edhe me shume dhe sigurisht që çdo herë kërkoj nga vetja që te punoj edhe me shume nga ajo që është bërë.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, e falënderoj kryetarin për prezantimin e raportit vjetor edhe sigurisht se do të flas si opozitë konstruktive pasi së pari inkurajoj për të gjitha punët dhe projektet e mira dhe disa që janë duke vazhduar për tu kryer mirëpo do të cekim edhe disa gjëra tjera që ndoshta ka mundur me u bo edhe pak me mirë. Në faqe 25, meqë është fjala këtu për një dokument dhe mund të këtë edhe gabime tjera por vetëm një po e përmendi pra në faqe 25, diku ka fundi shkruan shërime të fiziatrisë në QMF-ë pra do të ishte mirë me përmirësua sepse është dokument dhe të shkruhet shërbime të fizioterapisë, pastaj faqe 8 shkruan se janë përfunduar trotuaret në disa vendbanime në komunën e Rahovecit, e në mesin e tyre shkruan edhe në fshatin Celinë mirëpo tash do t'i drejtohem drejtorit të shërbimeve publike pasi në fshatin Celinë asnjë metër e trotuarit nuk është ndërtuar sepse disa rrugë janë aq të ngushta edhe nuk lejojnë të ndërtohet trotuar aty mirëpo edhe aty ku lejohet nuk është ndërtuar as edhe një metër trotuar. Pastaj në faqe 33, e keni cekur të hyrat nga taksa afariste komunale, deshta me dit sa janë të hyrat krahasuar me vitin 2019, pasi që e keni cekur se janë rrit për vitin 2020 dhe në faqe 41 në raportin tuaj e keni asfaltimin e rrugës Fortesë Celinë dhe aty kërkoj që të përmirësohet dhe të shkruhet riparimi i rrugës dhe dua të ju falënderoj që e keni kryer atë punë se me të vërtetë u krye një punë e mirë pasi u kon e pakalueshme por nuk është kryer asfaltimi i krejt rrugës por është bërë riparimi i pjesëve ku ka qenë e dëmtuar. Pastaj, siç e ceken edhe të tjerët se kemi pas edhe vërshime dhe normalisht që edhe në vendet më të përparuara të botës ndodhin vërshime dhe nuk mundemi me fajësua kërkon pasi janë nga dukuria natyrore por unë ju kisha inkurajuar për vitin 2021 nga mundësitë buxhetore që ka komuna e Rahovecit shtratin e lumit Bellaja me trajtua deri te Drini i Bardhë me rregullua në mënyrë që ujërat të mos dëmtojnë fushat e Celinës, e Fortesës, Xërxe, Rogovë por ato ujëra të derdhën në Dri dhe kur të rregullohet ai lum, atëherë unë e konsideroj nuk do te kemi vërshime dhe pjesa e përroit të Celinës që u rregullua u bo shumë punë e mirë edhe i ka dhanë efektet e duhura sepse uji është grumbulluar se ka ardh nga Bellaja mirëpo e vërteta qëndron se brenda një kohe shumë të shkurtër është kulluar, kurse viteve të kaluara rrinte sikur liqen uji nëpër ato fusha. Kështu që duhet të vazhdohet edhe naltë mbi fshat gjithashtu edhe poshtë pjesës së asfaltit që mos të kishim pastaj probleme me vërshime. Pra, rreth raportit ju përgëzoj për punët që keni bërë, por, tash jashtë raportit e kam cekur edhe në mbledhje të KPF-së që këtë foltore mundësisht me largua anash diku nëse e lejojnë kushtet teknike.

Kryetari – Asfaltimi i rrugës Fortesë Celinë është gabim teknik sepse është renovim apo riparim i rrugës edhe kodi është si i tillë. Pastaj pastrimi i lumit Bellaja që fola edhe me herët se tash veç i kemi identifikua pikat kritike dhe besoj se sivjet do të kemi aktivitete sepse jemi te vetëdijshëm se edhe nëse rregullohet shtrati i lumit Rimnik dhe nëse nuk pastrohet ajo zonë dhe nuk shkon deri ne Dri sigurisht se prap ka me pas telashe ose mundet me pas telashe ndoshta jo ne zonën e banuar por ne tokat bujqësore. Po ashtu kemi dëmtime ne pjesën e shtratit në fshatin Celinë dhe e kemi lutë operatorin me i riparue ato dëmtime nga pjesë te betoni që kanë rae nga vërshimet. Pastaj sa janë te hyrat, në vitin 2019 kishim 1,308,477 euro te hyra, ne vitin 2020 kemi 1,395,667 euro dhe diferenca ne te hyra te rregullta është 87,189 euro me shume ndërsa me te hyra te rregullta është 79,000 me shume. Pra kemi një tejkalim te të hyrave prej 87,189 euro pasi asnjëherë komuna jonë nuk ka mbërri me shkue n kete shume prej 1,395,667 euro. Tek trotuaret, nuk kemi kodë specifik te trotuareve në fshatin Celinë dhe tash është bërë një lloj si rrethrotullim dhe është futur ne këtë kodë te rregullimit te trotuareve pasi nuk kemi pasur mundësi ndryshe me implementue kontratën. Prandaj edhe kjo nëse tingëllon keq mirëpo e vërteta është kjo pasi jam konsultuar me Përparimin rreth kësaj pune, pra kodi është trotuaret dhe tash është futur edhe ai pozicion dhe e ftojë me korigjue sepse nuk tingëllon mirë pasi trotuare nuk kemi bërë ne Celinë por kemi bërë ne atë pjesë por është pjesë e asaj kontrate. Pastaj që e potencove te sherimet, mendoj që ka të bëj me sherbime fizioterapeutike dhe është gabim teknik dhe sigurisht që kemi fizioterapeut dhe normalisht detyra e tij është sherue njerzt dhe kjo është sherbim I fizioterapeutit. Po ashtu Sali Sallteku nuk po majtohet mirpo ju drejtohem edhe njeher se nuk ka veprime ne atë zonë dhe nuk mundet me pas veprime uzurpuese sepse është prone e DKA-së dhe pa miratimin e Kuvendit dhe sigurisht që kuvendi nuk besoj që ka arsye me ja miratue dikujt privatisht. Keshtu që për mua është shume e ligjshme kur e bon një kerkesë ne kuvend ndoshta me shume vlen kur e ban kerkesën një kryetar I fshatit, por sidoqoftë edhe njeher e them proceduralisht duhet m bo kerkesë per me angazhue ekipi I gjeodezise per me shkue ne terenë dhe gjithashtu ja dhash edhe një sqarim tjetër që mundet mos me u pajtue dhe mundet me vertetue që ne kemi mungesë te resurseve humane ne drejtorinë e gjeodezise kadastrës dhe pronës dhe nuk kemi njerës tani për me krye sherbime dhe po kemi vonesa ne realizimin e disa objektivave që kanë te bëjnë me matje gjeodezike nga komuna jonë për shka edhe te pandemis pastaj per shkak te reduktimit te stafit edhe per shkak te mungeses se stafit edhe sikur most e ishte gjendja e pandemisë, pra kemi vetem një gjeodetë sespe kanë dale ne pension dhe nuk kemi pas undesi me rekrutue për shkak te ligjit te ri të zyrtareve public dhe ky është sqarimi sa i përket kësaj çështje.

Sali Sallteku – Unë ju falënderoj për raportin vjetor të punës, por, unë mendoj se menaxheri i pronave të shkollës dhe i krejt punëtorëve të shkollës është DKA-ja dhe ajo duhet me krye këtë punë dhe nuk vjen kryetari i fshatit për DKA me bo kerkesë dhe kjo është pergjegjësi e drejtorit të DKA-së. Gjithashtu, ju kuptoj se nuk keni staf nga gjeodezia për momentin mirëpo mendoj që nuk është e arsyeshme që kryetari i fshatit me bë kerkesë për pronë të shkollës kur e dimë se përgjegjës është drejtori i DKA-së.

Kryetari – Pronën e DKA-së e administron DKA-ja por matjet gjeodezike nuk i bon dhe këtë e dini shume mirë edhe ju dhe ju e dini që kur del gjeodezia apo kadastra ne terenë duhet me pas kerkesë dhe ne me rregullore te kuvendit te komunës e kemi miratue dhe tash kryesive te fshatrave kur ka per interes publik dhe te lagjeve ne nuk ju kërkojmë atë taksë sepse qdë person person privat që e paguan shërbimin gjeodezik dhe ne kete rast mos u frikëso se pronën e DKA-së dhe pronën e komunës e kemi obligim ligjor me mbrojte bashkë. Unë mendoj se kjo punë do te kryhet dhe ju siguroj se asnjë lëvizje te pronës nuk mundet me u bo pa vendim te kuvendit te komunës dhe ju e dini që te gjithë. Mirpo nëse ka uzurpim atëherë është krejt diqka tjetër pra është një situatë tjetër dhe prap kemi mekanizma te parapamë me ligje që veprojnë por tash per tash nuk ka uzurpim pasi nuk ka lëvizje, ai ka ardh edhe ka biseduar me drejtorin e arsimit dhe ka kërkuar se qka mundemi me bo. Por tash vetëm kuvendi i komunës mundet me i hapë rrugë dhe askush tjetër nuk mundet me vendos sa

i takon kësaj. Keshtu që komuna e Rahovecit ka kapacitete me i dhanë përgjigje përmes kuvendit të komunës shqetësimeve të tilla. keshtu nuk keni nevojë të shqetësoheni se mundet me u dëmtua prona e institucionit publik pa vendimin e kuvendit të komunës. Keshtu që pajtohem edhe une se duhet me u bo matja mirpo gjeodezia para se me u bo matja duhet me pas një kërkesë të protokolluar, mirpo edhe tash une kërkoj nga drjetori i kadastrës që me shkue edhe me pae per se afërmi gjendjen që ekziston aty.

Fehmi Cena – Faleminderit kryesues, unë kam disa vërejtje rreth raportit, natyrisht raporti siç e elaboroj kryetari është gjithëpërfshirës dhe ka shumë punë të mira që janë kryer dhe plot aktivitete siç e tha edhe kryetari, por, sigurisht që kanë mundur edhe shumë punë tjera të bëhen dhe unë i kam disa ndërhyrje, si në faqen 7, plani lokal i veprimt në mjedis ku shkruan se e kemi shqyrtuar dhe e kemi aprovuar dhe atëherë kur e kemi diskutuar e kemi thënë se ky është një plan strategjik dhe nëse ekzekutivi bën projekte të mira atëherë ka mundësi me thith edhe donacione nga jashtë. Me këtë raport unë nuk kam parë ndonjë projekt apo donacion që do t'i gëzohesha sigurisht nëse bëhet sepse shfrytëzon buxhet jashtë komunës tonë ose nëse ka ndonjë projekt na tregoni. Tek punët në rrjetin e kanalizimit po shihet se janë bërë disa punë të mira nëpër shumë vendbanime ku ceket edhe Rahoveci, por, unë kam vërejtje pikërisht këtu pasi nuk di sa është punuar sepse ende kemi shtëpi dhe lagje në qytet që nuk kanë rrjet kanalizimi ose nuk kanë qasje në rrjet kanalizimi dhe unë besoj se ju jeni në dijeni që janë shumë probleme të ndryshme, por, është komuna e cila duhet të angazhohet në zgjidhjen e atij problemi. Mungesa e rrjetit të kanalizimit për mua brenda qytetit edhe në çdo vendbanim tjetër e sidomos në qytet është e papranueshme, investime në gropa septike dhe impiante gjithashtu nuk janë bërë sa duhet dhe mendoj se duhet më tepër investime me u bo në atë drejtim, po ashtu rreth kanalizimit të ujërave atmosferik është një projekt që keni filluar në qytet dhe ne kemi kërkuar edhe më përpara që qyteti i Rahovecit ka nevojë për shumë punë që të kryhen në këtë drejtim dhe mund të them se brenda këtij viti është punuar, mirëpo jo aq sa duhet kështu që nuk mund t'i gëzohemi punës që është bërë. Pastaj u përmenden vërshimet ku këtu ka mjaft investime në rregullimin e shtretërve të lumenjve, përroskave vijave kulluese mirëpo megjithatë e shohim sa herë po bie shi pak më tepër prapë kemi vërshime dhe përmytje në toka bujqesore dhe vendbanime dhe po ballafaqohemi me dëme të mëdha dhe po duhet me i vlerësue ato dhe nuk mundeni as ju e as qeveria me i kompenzue ato, kështu që nuk është punuar mjaftueshëm apo cilësia e atyre punëve nuk është e mjaftueshme, pra, efektiviteti nuk po shihet aq sa duhet. Pastaj tek uji për pije, pra, uji higjenik për pije, është diçka që unë e vlersojë këtë çështje dhe ju e keni cekur 3 fshatra si Mrasor, Kaznik dhe Zatriq e që në fakt ka edhe fshatra tjerë që nuk kanë ujë higjenik për pije si Opterushta, Zogisht, Drenoci sigurisht që kanë ujë prej burimeve lokale, por, nuk është për pije dhe sa herë bjen shi ata duhet të presin me ditë e javë deri sa të pastrohet uji sepse ajo e rrezikon shëndetin publik të atyre njerëzve. Kështu që, unë mendoj se në këtë drejtim duhet të kemi më shumë investime. Pastaj shtëpia e pleqëve është duke u punuar dhe unë mendoj që duhet të punohet me një dinamikë më të madhe në menyrë që kjo shtëpi të jetësohet sepse kemi të bëjmë me një kategori të njerëzve që vërtetë janë me një gjendje të keqe dhe nuk kanë ku ta kalojnë kohën kohën pasi i shohim nëpër lokale ku nuk kanë kushte të mira me qendruar aty apo skaj rrugëve dhe kjo nuk është diçka e mirë edhe pse ne e kemi shprehur vërejtjen tonë që kjo shtëpi e pleqve, pozita ku është mendoj se nuk është shumë e përshtatshme pasi është shumë larg dhe nuk e di sa do të jetë funksionale ajo, por sidoqoftë do të ishte me u rregullue sa me shpejtë. Pastaj trotuaret që janë ndërtuar në vendbanime edhe ne Rahovec, nuk e di në cilën rrugë është ndërtuar ndonjë trotuar dhe unë e kam cekur disa herë rrugën Dëshmorët e Pashtrikut që është prej rrugëve kryesore në qytet edhe për trotuarin edhe për rrugë nuk është bërë asnjë metër kubëzim sa i përket rregullimit të trotuareve. Tek shëndetësia i kam disa ndërhyrje, mendoj se janë bërë disa punë të mira në renovimin dhe ndërtimin e objekteve. Mendoj se janë bërë disa punë të mira në ndërtimin e disa objekteve si QKMF-ja është një objekt shumë i mirë tash që është ndërtuar i cili ofron kushte më të mira për punë, si për punëtorët shëndetësorë ashtu edhe për pacientët. Po ashtu rreth aparaturës kemi pasur disa vërejtje ku rendgeni

digjital është siguruar, EHO nuk është siguruar mirëpo mendoj që ka qenë një mangësi pasi kemi pasur kuadër të specializanteve që kanë mundur me i shfrytëzua këto aparatura, pastaj një problem tjetër që e kam cekur edhe më përpara pse drejtoria komunale e shëndetësisë nuk e formon komisionin mjekësor për certifikata për patent shofer pasi ka mundësi që është një shërbim do të i shërbente qytetarëve tanë por njëkohësisht edhe krijon të hyrat për shëndetësi. Për repartin e Hemodializes ju dhatë shpjegime, e dimë si qëndron problemi aty pasi nuk është faji juaj mirëpo megjithatë unë kisha kërkuar që të punoni në atë drejtim që ky repart të hapet pasi që aty janë bërë investime pasi që është shërbim shumë i rëndësishëm pasi kemi një kategori të njerëzve që vërtetë aty do të merrnin një shërbim shumë të mirë. Rreth pandemisë kam fjalë të mira, pasi është menaxhuar pandemia mirë edhe pse ne i kemi pasur disa vërejtje tona rreth atyre tuneleve dezinfektuese pasi është dashtë me tepër me pas, pasi kërkesa ka qenë me pas në çdo institucion dhe nuk është bërë, gjithashtu kemi kërkuar si staf testet serologjike për punëtorët shëndetësorë sepse në shumicën e komunave janë kryer testet serologjike për shkak se pandemia po vazhdon dhe nuk e dimë se kush prej punëtorëve shëndetësorë kanë imunitet dhe kush nuk kanë pastaj kush është i rrezikuar apo jo. Pra, kjo është diçka që ka qenë në plan në nivel vendi por nuk është bërë. Së fundi një vërejtje për Qendrën për Punë Sociale se na nuk kemi asgjë në raport për punën në qendrën sociale pasi mendoj se është dashtë me pas edhe pjesën e statistikave për numrin e familjeve, rasteve që janë duke marr ndihma sociale, e dimë që si proces dhe ka ndryshime brenda vitit por ne duhet të dimë se sa është numri i tyre sa janë të reja pastaj sa janë larguar e kështu me radhë.

Kryetari – Raporti i drejtorisë së qendrës për punë sociale është i publikuar në webfaqen e Komunës, po i pergjigjem Fehmi Cens se QPS-ja e ka atë publikuar raportin në webfaqe zyrtare pasi është një sektor dhe tash ne nuk mund të kemi edhe raportin e QKMF-së edhe QPS-së por raportin e ka të publikuar në webfaqe e ndoshta ka mundur me qenë edhe pjesa e shkurtuar e raportit të QPS-së këtu. Pastaj testet serologjike e kemi diskutuar edhe me drejtorinë e shëndetësisë dhe nuk besoj që është i pergaditur stafi shëndetësorë për me aplikue kete standart edhe me plotësue kete shërbim për shkaqe që besoj që janë të njohura pasi nuk ka asnjë laborator në komunën tone që është i çertifikuar për me bo teste keshtu që nuk mundemi me bo teste serologjike pasi nuk e kemi marr atë çertifikatën për me krye, sigurisht që do të ishte mire me bo edhe komuna jonë por nuk ka as laborator as të licencuar bile kam vërejtje në laboratorin e QKMF-së pasi her ankohen për mungesë reagentesh keshtu që nuk jam shume i kënaqur rreth kësaj. Pastaj komisioni mjekësor për certifikata, siç e dime e kemi diskutuar edhe në kuvend se e kemi bërë dikur mirpo nuk ja ka vlejte por tani ne mungesë të drejtorit të shëndetësisë do të ishte mire me ju pergjigj me shkrim pasi ka 2 apo 3 herë që e keni ngritë kete çështje por nuk është që mbërrin komuna me prodhues ndonjë të hyrë apo që është ndonjë komision që ka funksionue ndonjeher. Menyra si është nderprerë e dini edhe ju besoj, me duket ka qenë Shani Bajraktari përgjegjës për certifikata. Ne kemi nënshkruar për paisje mjeksore, për rendgen digjital pastaj EHO e plot paisje tjera mjeksore dhe besoj që do të vijë shume shpejt veqse një pjesë ka ardhë ju e dini ka ardh për stomatologji dhe paisje tjera edhe një pjesë tjetër do të vijë shume shpejt sepse edhe operatorët po ngurrojnë me i sjellë paisjet pa i marr parat. Tash po besoj që do të kemi një situatë shume me positive sa i takon paisjes se sektoreve në QKMF- me aparatura mjeksore të nevojshme. Pastaj sa i takon trotuareve, ne kemi bërë disa trotuare edhe në qytet si rruga Deshmoret e Pashtrikut pikerisht ka rruga që shkon ka shpirta juaj Fehmi Cena sigurisht se ka problem edhe me ujëra të shiut, por ne kemi fitue një kodë prej ministrisë të infrastruktures edhe kodi thirret ndertimi i rrugëve në qytet. Do të shohim se qka mund të bëjmë edhe me ujëra e jo vetem me trotuar pasi ju e dini qfar kercenimi vijë nga prurjet e ujërave atmosferik keshtu duhet me mendue edhe ndonjë kanal të hapur të kullimit në funksion të zbutjes së gjendjes me vershime në qytet. Gjat ketyre diteve e kemi pa se vershimet në qytet kanë qenë me të pakta edhe kam një pershtypje që ne sa her bjen shi i rahatshëm dhe i qetë nuk do të kemi përmbytje dhe vershime por kur po vijë shi i rrëmbyeshëm atëher për një kohë shume të shkurtër po vershon gjithqka. Kështu që ky kanal që po hapet tash e që po ndërtohet ky do ta kryen

vetëm një funksion kështu që duhet kanale shtesë për me zvogëlue vëllimin e ujërave në qytet edhe ne jemi duke e analizuar edhe një kodë që e kemi ne Ministrinë e infrastrukturës do të shohim se a mundemi me futë ne kuadër te ndërtimit te rrugëve trotuareve edhe si kanale te vogla te kullimit që se paku me zbutë gjendjen me ujërat ne qytet. Si e thash edhe me herët se do të thellohet shtrati i lumit Dullo dhe do të vazhdoj trajtimi i shtratit pasi e kemi kodin ne drejtorin e Bujqesis dhe do të vazhdojë deri ne Fortesë. Te efekti i kanaleve të shtretërve te lumejve, une mendoj që sido që te jetë këto shtretër që janë bërë me kualitet apo pa kualitet kanë ndikuar ne masë te madhe që te zvogëlohet potenciali dhe kërcënimi i përmbytjeve të mëdha. Pastaj ne Fortes; asnjeher lumi nuk ka dalë prej shtratit por ka edhe ujëra tjerë që tash duhet me i analizue edhe këto pika që realisht ka ujëra që vinë edhe nga anë tjera që tash duhet me këqyr çka mundemi me bo veprime shtesë që shtretërit me funksionue me mirë edhe mos me pas asnjë lloj fyerje ku ka pengesa pastaj te Bellaja e qishtut është edhe ne qytet. Po ashtu edhe lagjja e Durguteve ka një fryerje te lumit dhe aty ndodh për shkak se te ura e haxhi ademit ka një problem edhe shume probleme tjera që shfaqen e po ashtu që njerëzit kanë ndërtuar edhe pronën e lumit që unë kam vërtetuar gjëra që janë te papranueshme totalisht, që ka edhe të tillë që e ka uzurpue grykën e lumit dhe e ka përkthye si pronë te veten, pra kemi probleme edhe te kësaj natyre, pra jo vetëm që e ka uzurpu por e ka qitë edhe përmbi vete pronën e lumit, pasi ne çdo vend te botës ujërat mbrohen kurse te na nuk mbrohen sepse ka njerëz te papërgjegjshëm që gjënë mundësi ne gjykata dhe i kthejnë si pjesë te pronës se tyre. Ne nuk kemi të drejtë me operue kështu që duhet me gjet modalitete edhe me u marr vesh me dikën. Po ashtu ujërat e zeza kemi në qytet dhe plot probleme kemi zgjidhur dhe plot probleme janë te pazgjidhura. Një lagje që vazhdimisht e ngritë zërin sigurisht që me te drejtë e ngritë zërin por ata kanë probleme mes vete pasi ne nuk mund te hapim kanale nëpër oborre nëse ata nuk na lejojnë dhe sigurisht që i kam takuar përsëri dhe kam marr përsipër me bo diçka me konkrete që me pas mundësi me bo një zgjidhje me kompromisin e tyre. Por unë nuk jam fajtor por as kryetaret e mëparshëm nuk janë fajtor, nëse ligji ta pamundëson që ju me ndërhyje në mosmarrëveshjet evidente në një lagje te caktuar në qytet që ndoshta 200 familje nuk kanë të rregulluar kanalizimin e ujërave te zeza. Unë kam biseduar me qytetaret e kësaj lagje dhe kam njëfarë vetëbesimi dhe do të shohim se çka do të mund te zgjidhim për këtë çështje pasi e di atë problem dhe ne momentin ata gjejnë një kompromis mes vete atëherë edhe unë e konkretizoj në punë pasi edhe kompania është e gatshme e sidomos për raste emergjente. Pastaj tek shtëpia e pleqve, që është ne prag të përfundimit pasi është e kontraktuar edhe për këtë vite dhe shpresojmë ta përurojmë dhe atyre pleqve te moshuar do të ju siguroj transportin publik, pra do të hapi procedurë që 3 apo 4 herë ne ditë me shkua atje dhe po ashtu me ju sigurua edhe disa kushte me disa mjedise te mira dhe te qeta për me luajt shah, letra pastaj shëtitoren dhe gjithashtu do te mundohem që me ju sigurua edhe një ushqim. Pra ne si komunë do të mundohemi me u kujdese për te gjitha kushtet e nevojshme. Arsyeja se pse është paksa larg është se nuk kishim pronë afër në qytet dhe u detyruam të bëjmë atje dhe mendoj se edhe për shkak te kushteve atje do ta kalojnë atje për shkak se edhe kushtet klimatike janë me te mira atje nalt dhe do ti kenë të gjitha kushtet e nevojshme për pushim ditor. Pastaj uji i pijshëm në Opterush Kaznik dhe Mrasor është e vërtet që sa herë që ka reshje fshati Opterushë nuk mundet me pie ujë pasi është jo higjenik edhe i dëmshëm siç ka edhe ne disa vendbanime tjera edhe pse i ka në menaxhim KRU. Gjakova. Pra dy probleme janë këtu, e para që ne duhet me u kujdes që mos me përdorë ujin që nuk është adekuat për pije dhe jo higjenik edhe që mund te jetë i dëmshëm dhe që prodhon efekte anësore ne shëndetin e njerëzve .KRU.Gjakova e ka marr përsipër me menaxhua por ne kemi një projekt e që ndoshta mos po lidhet me Hoçë të Madhe dhe Zoqisht që po deshirojn me sjellëu ujin edhe për këto 3 fshatra prej liqenit te Radoniqit kurs për Mrasor dhe Kaznik shfrytëzojnë burimet alternative dhe jo burimet e liqenit te Radoniqit por sidoqoftë unë i ftojë ata që dinë me i bo këto analiza dhe do te ishte mirë që qytetaret mos me përdor ujë jo higjenik. Te gropat septike dhe kanalizimet po ashtu sivjet prape kemi kontratë dhe të shohim se çfarë po mundemi më mbërri që me zbutë shqetësimet e

sidomos ato që janë me të mëdhaja për trajtimin e ujërave të zeza. Te plani lokal i veprimit, ka prodhues efektet e veta pasi kemi marr grant prej Ministrisë së mjedisit tash në fund të vitit për shkak se jemi fitues të grantit për mjedis të pastër. Pasi edhe ky plani për mjedis të pastër ka prodhues këtë efektin sepse në këtë Ministri ai grant nuk është vetëm i Ministrisë dhe planifikimit të Ekonomisë dhe ambientit por marrin pjesë edhe Demos, Gizi edhe disa organizata të huaja që i vlerësojnë komunat që kanë një mjedis të pastër.

Afërdita Thaqi – Përshëndetje kryetar dhe gjithë ju të pranishëm. Më shumë vëmendje i dëgjova përgjigjet që i dhatë rreth përrënjeve dhe ujërave të zeza nuk di edhe çfarë të them në atë drejtim por për përgjigjen e doktorit që nuk bëhen teste serologjike nëse nuk punohet në Rahovec atëherë mundet me bo një marrëveshje me Gjakovë edhe me i dërgua disa persona sa ju lejohet që me shkua me i bo ambulantë të qytetit, ky është vetëm një mendim i imi dhe nuk e di sa është e mundur.

Kryetari – Sigurisht që po i bëjnë në Gjakovë, Prizren edhe në plot vende mirëpo pa marrëveshjen tonë edhe po besoj se njerëzit pak edhe s'po dojnë me i pague ka 20 euro edhe kapak kanë edhe frikë edhe të testohen se po dalin pozitiv.

Sali Sallteku – Kërkoj që po dal jashtë teme mirëpo siç e dini se në nivele komune jeni të informuar se është mbytur një mësues të Drini të Bardhë konkretisht të Ura e Fshejtë dhe ende nuk është gjetur dhe ndoshta drejtori i DKA-së mund të na jap ndonjë përgjigje dhe si qëndron gjendja e familjes së tij që a ka nevojë me ju ndihmua dhe i ofrua ndihmë.

Kryetari – Nuk është gjetur trupi i pajetë i tij, po ashtu edhe njësitë e FSK-së janë funksion të gjetjes së tij por nuk po mundën me bo shumë veprime për shkak se rritjes së nivelit të ujit në Drinin e Bardhë dhe uroj që të zbardhet ky rast sa më shpejt që është e mundur dhe shpejt, pasi rasti ka shkua edhe në polici dhe prokurori dhe janë duke hetuar rastin pasi ishte një mësues i mirë dhe i familjes së mirë por vërtet është një fatkeqësi që nuk nuk është menduar mirë në momentin e hedhjes në Dri pasi ka kërkuar edhe ndihmë por për shkak të ujit të rrëmbyeshëm ka qenë e pamundur. Sigurisht që do të solidarizohemi me familjen së tyre për shkak të gjendjes së rënduar dhe urojmë që sa më shpejt të gjendet trupi i viktimës dhe të varroset, pastaj nëse kemi ndonjë situatë natyrisht që do të i ndihmojmë edhe familjes së tij.

Kryesuesi – Faleminderit kryetar për sqarimet, kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

3. Raporti vjetor financiar për vitin 2020.

Afrim Limani – Përshëndetje për ju kryesues, kryetar dhe gjithë ju kuvendarë të nderuar. Fillimisht dua të jap një informatë se Raporti Financiar i komunës së Rahovecit për vitin 2020 është i publikuar në webfaqen e komunës dhe gjithë ata që ju intereson mund ta gjejnë në webfaqen e komunës. Për dallim prej raporteve tjera periodike si 3 muhor, 6 muhor dhe 9 muhor, ky raport është shumë më i madh dhe më dimensional dhe në këtë raport janë të përfshira gjitha aktivitetet dhe gjitha ngjarjet të cilat janë zhvilluar në komunën e Rahovecit gjat vitit 2020. Pra raporti përbehet nga pjesa e të hyrave, pjesa e shpenzimit të buxhetit, pjesa e shpenzimit të komunalive po ashtu në raport janë të përfshirë edhe kontratat e nënshkruara nga zyra e prokurimit dhe gjithashtu janë të paraqitura në mënyrë të detajizuara edhe shpenzimet në formë analitike dhe krejt në fund e kemi edhe raportin e obligimeve financiar të cilën e kemi bartë nga viti 2020 në vitin 2021. E dimë të gjithë që ka qenë një vit i vështirë dhe sfidues por përkundër kësaj situatë në kemi arrit që të hyrat tona të i realizojmë me një shumë të kënaqshme edhe mund të them se këto të hyra janë me të mirat historikisht deri në këtë vit. Gjithashtu edhe shpenzimi i buxhetit ka arrit në shumën prej 98,50% edhe mjete në suficit kanë shkua vetëm sa për informimin tuaj vetëm 25,000 euro jo që në nuk e kemi krye atë obligim por të gjitha pagesat të cilat janë bërë në datën e fundit të pagesave ato mjete nuk kanë mundur me u ekzekutua si arsyetim nga Ministria e Financave sepse ka deficit buxhetor edhe ska pas mjete me u ekzekutua. Unë do të mundohem që në pika të shkurtër të ju shpjegoj raportin që me ju lanë hapësirë edhe juve me parashtua pyetje. Ashtu siç thash edhe në fillim dallimi i të hyrave është 87,189 euro e kemi arritë që ti tejkalojmë planifikimet e tona dhe me një ndryshim prej 87,189 euro. Se ku kemi të hyra me shumë eventualisht me pak që ka ngecje, ju mund ta shihni

tek te hyrat sipas kategorive ekonomike ne faqe 6. Në faqe 7, kemi të prezantuar shënimet e tatimit ne pronë, te them të drejtën ne cilësinë e drejtorit te Financave edhe pse është ne kuadër te drejtorisë time nuk jam i kënaqur me realizimin e të hyrave ne raport me planifikimin që e kemi pasur edhe ne raport me vitin e kaluar sepse planifikimi i tatimit ne pronë për vitin 2020 ka qenë 541,173 euro ndërsa ne kemi arrit te inkasojmë 456,977 euro me një dallim negativ prej 34,000 euro. Arsyeja është që kemi kalua në një situatë të vështirë edhe te them të drejtën edhe jemi tregua edhe tolerant ne raport me qytetaret tanë që nuk i kemi detyruar ne njëfarë forme që me pagua tatimin ne pronë edhe kjo kryesisht ka rezultue. Në faqen 8, kemi te prezantuar shpenzimin e buxhetit në kuadër te programit sipas kategorive ekonomike ndërsa ne faqen numër 9, kemi shpenzimin e buxhetit sipas kategorive ekonomike te shprehur në përqindje, do të thotë shpenzimi i buxhetit ne total duk përfshirë të gjitha kategoritë është 97,90%. Buxheti fillestar që ka qenë prej 14,735,000 ka dallim me buxhetin final që kemi pasur prurje tjera si bartja e mjeteve si dhe një donacion nga qeveria e Kosovës si rimëkëmbje ekonomike dhe buxheti me dallim nga ai fillestar është 14,718,244 euro. Në faqe 10 e tutje kemi te prezantuara shpenzimin e buxhetit në kuadër te mallrave dhe shërbimeve sipas kategorive ekonomike dhe ne faqe 15 është ri kapitullim i gjitha këtyre shpenzimeve në kuadër te kodeve ekonomike dhe kemi raportin prokurimit dhe krejt ne fund i kemi obligimet financiare të cilat i kemi bartur nga viti 2019 në vitin 2020 që ne total janë 978,943 euro, në kuadër te mallrave dhe shërbimeve kemi 89,514, komunal 1205, subvencione 4450 dhe ne kuadër te investimeve kapitale 978,943 euro. Te nderuar asamblistë ju falënderoj për vëmendjen tuaj, pres pyetje nga ju.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, e falënderoj drejtorin për paraqitjen e Raportit Financiar për vitin 2020. Fillimisht ndoshta janë lëshime teknike apo unë nuk e kam kuptuar mirë, në faqe 4, ku kemi te gjobat e gjykatave në total e kemi te shkruar 14,344 euro ndërsa në faqe 5 shkruan 13,391 euro të hyrat e rregullta ku shkruan aty gjobat e gjykatave dhe gjobat në trafik d.m.th. është një shifër që ndryshon në faqe 4 dhe ndryshe në faqe 5, që me siguri është ndonjë gabim teknik e që duhet me u përmirësua. Pastaj faqe 7, kemi planifikimi dhe realizimi i tatimit në pronë, ku përqindja e realizimit edhe në herën e parë 2019 dhe po ashtu herën e dytë 2019 dhe sigurisht që njëra duhet me qenë 2020 dhe duhet të përmirësohet dhe tash po hyjmë në analizë të buxhetit ne përgjithësi te raportit. Është e vërtete që realizimi i të hyrave të rregullta është mbi planifikimin për 25,582 euro edhe pse ka qenë vit i vështirë për shkak të pandemisë Covid 19 por vlen për me u vlerësua se ka qenë një realizim i mirë por në fillim kur patëm folur për kornizën afatmesme buxhetore edhe për buxhetin para aprovimit të buxhetit, e kam thënë edhe tani po e mbrojë atë çka e kam thënë pasi të hyrat në komunë nga viti në vite po rriten, kështu që është një çudi te Ministria e Financave në vitet paraprake kur realizimi i të hyrave buxheti ka qenë më pak atëherë ata planifikimin e bojshin mbi 1,600,000 dhe tash kur të hyra ka më tepër e kanë bo 1,200,00 d.m.th. në bazë të planifikimit që është atëherë është realizua buxheti mirë dhe krahasuar me vitet paraprake, ky është realizimi më i mirë këtë vit që u bo. Por, tani kam vërejtje te planifikimi pasi duhet me qenë më i madh për vitet tjera e jo me bo planifikimin e vogël kurse realizimi me u bo më i madh. Pastaj gjobat e gjykatave, ju thatë që gjobat në trafik keni realizim më të mirë krahasuar me vitin 2019 kurse te gjobat e gjykatave dihet se nuk kemi realizim dhe rrethanat dihet pasi nuk varen prej komunës sigurisht, pastaj te realizimi i të hyrave te realizuara sipas kodeve ekonomike, unë mendoj se realizimi i tatimit në pronë për vitin 2020 që gjithashtu edhe ju e përmendet sigurisht që lë për të dëshiruar krahasuar me planifikimin për vitin 2020 pasi kemi realizim 84,195 euro më pak. Po ashtu për disa sqarime nëpër disa kode, kemi kodin 50026 taksa për legalizimin e objekteve, kanë qenë për vitin 2020 planifikimi 14,000 që ka qenë planifikimi i vogël por është mirë që është bërë një progres pra rritje 31,067 euro ka shkruar realizimi për vitin 2020. Pastaj kodi 50405 shfrytëzimi i pronës publike që ka qenë planifikimi 13,000, por, këtu ka rënie në 4450 euro, pastaj kodi 50409 participimet në bujqësi, realizimi për vitin 2020 është i mirë por nuk e kuptoj se pse planifikimi ishte aq i vogël kur dihet mirëfilli se në vitin 2019 realizimi ka qenë mbi

100,000 euro. Pastaj faqe 9, nëpër kategori ekonomike unë si anëtar i kuvendit mundem me thanë se realizimi i buxhetit për vitin 2020 në total është i mirë nëpër të gjitha kategoritë ekonomike. Te mallrat dhe shërbimet sipas kodeve ekonomike kemi rritje të shpenzimeve në mallra dhe shpenzime krahasuar me vitin 2019 që pra për vitin 2020 kemi 312,790 euro më shumë se sa në vitin paraprak, pra edhe këtu do ishte mirë me na dhanë sqarime p.sh. me intereson kodi 13640 kemi furnizime pastrimi që ka qenë 12,725 në vitin 2019, kurse për vitin 2020 kemi 66,741, pastaj kodi 14020 mirëmbajtja e ndërtesa ka qenë 35,678 euro në vitin 2019, kurse për vitin 2020 kemi 83,114 euro që gjithashtu edhe këtu kemi rritje të madhe krahasuar me vitin 2019. Pastaj kemi kodin 14024 mirëmbajtja e objekteve shëndetësore ka qenë 26,689 euro në vitin 2019, kurse në vitin 2020 i kemi përafërsisht 60,000 euro pra kërkoj si sqarim se si ka ardhur deri te kjo. Pastaj te raporti i kontratave të nënshkruara, titulli aktiviteti i prokurimit që kemi hartimi i projekteve të ndryshme ri-tenderim dhe pyetja për ju do të ishte kjo, pasi në kornizën afatmesme buxhetore e di që kemi paraparë shuma për hartimin e projekteve 30,000 apo 40,000 euro në vit, mirëpo këtu shkruan hartimi i projekteve të ndryshme ri tenderim është një kontratë e nënshkruar që kap vlerën 350,000 euro. Pyetja ime është se këto mjete kur e kemi miratuar buxhetin a kanë qenë te parapara, pasi procesi i prokurimit kur shkon a bazohet në buxhetin që e miraton kuvendi apo pastaj kontratat i nënshkruan ndryshe apo pa planifikim te buxhetit nënshkruan kontrata pasi unë nuk besoj që kjo shumë 350,000 euro janë paraparë për hartimin e projekteve të ndryshme pasi kjo shumë me duket e madhe dhe kërkoj sqarim. Po ashtu deshta me pyet për aktivitetin shërbime të realizimit te vitalizimit te infrastrukturës për funksionalizimin e projektit shtretërit shtëpiak, pasi edhe vitin e kaluar auditori ka dhënë disa vërejtje dhe pyetja për këtu shkon se deri ku ka mbërrirë realizimi i këtij projektit për shtretërit shtëpiak. Dhe në fund megjithatë këtu e keni cekur se obligime financiare komuna jonë për vitin 2020 i ka krejt 174,113.00 euro që kanë mbetur pa u përfunduar, pra, fjala është për këto shpenzimet kapitale dhe gjitha tjerat që janë krye punimet sigurisht faturat dhe shumat janë të cekura por e keni konstatuar se ky është borxh që ka mbete pa u paguar.

Fehmi Cena – Faleminderit kryesues, ne si Komitet për Politikë dhe Financa atëherë nuk kemi mundur me shqyrtuar këtë raport sepse nuk e kishim materialin mirëpo tash që e kemi materialin mjaft ka qenë i cunguar po mendoj për kopjen fizike pasi kanë munguar fletët, por, sidoqoftë unë do t'i referohem këtij materiali që e kam rreth të hyrave vetanake, drejtori në elaborim e sipër e cekur se shpenzimet nëpër kategori ekonomike ka qenë mbi 98% dhe mendoj se kjo është për tu përshëndetur sigurisht pasi është një punë e mirë që është bërë në këtë drejtim në raport me vitet tjera. Tek të hyrat vetanake tatimi në pronë dhe unë gjithmonë mendoj se Tatimi në pronë është pasqyra kryesore e të hyrave respektivisht e suksesit të punës së drejtorisë për Financa por edhe gjithë ekzekutivit dhe kjo është ajo pjesa më stabile që siguron të hyrat komuna dhe gjithashtu e shohim se edhe nga drejtori u tha që në raport me planifikimin është më pak dhe po ashtu është e vërtetë se ka qenë viti me pandemi edhe ajo ka sjellë vështirësi në arkëtimin e të hyrave mirëpo në çdo herë e kemi cekur edhe kur i kemi shqyrtuar raportet 3 mujore, 6- mujore, 9- mujore të financave që të gjinden format që mos të ndihet ajo mungesa e gjendjes së pandemisë që në këtë drejtim të arkëtohen sa më shumë të hyra, duke qenë se për këtë vit edhe taksat janë më të larta në tatimin në pronë pasi jo vetëm që paguhet në objekt por paguhet edhe në truall. Rreth këtyre kodeve janë disa që kanë diskrepancë mjaftë të lartë në raport me planifikimin edhe realizimin, mirëpo unë s'po dua me hy në hollësi sepse parafolësi z.Fazliu i cekur shumicën dhe vetëm kjo po bie në sy të hyrat nga shitja e mbeturinave që planifikimi ka qenë 32,000 kurse të hyrat janë zero. Kështu që është një kod që po përsëritet çdo vit që nuk ka fare të hyra dhe sigurisht që duhet me na dhanë shpjegim, përndryshe kur shikojmë te hyrat në raport me planifikimin po shihet se është i tejkaluar plani i të hyrave mirëpo edhe unë e ndaj mendimin e njëjtë me z. Fazliu pasi vërtetë të hyrat tash janë më të larta prej vitit në vit dhe kur kemi parasysh ne si kuvend dhe ne kemi bërë disa falje të bizneseve gjatë këtij viti në taksa, në qera të bizneseve dhe lokaleve dhe të gjitha këto kur të merren parasysh atëherë vërtet lind nevoja e një

planifikimi, të ndryshohet buxheti në të ardhmen, që do të thotë se tavani i planifikimit duhet të jetë më i lartë, pasi nuk është interesant të bëhet planifikimi më i vogël e pastaj të thuhet se ne i kemi tejkaluar por më mirë do të ishte që planifikimi të jetë më i lartë dhe pastaj të punohet të arrihet ai rezultat dhe synimi që i është vënë komunës për të hyrat vetanake.

Ali Zhuniqi – Mëqenese dy kolegët e mi paraprakisht i shtjelluan te gjitha, unë do të ndalem vetëm tek raporti i kontratave të nënshkruara që ndoshta nuk ka të bëjë direkt me drejtorin e financave por do të ndalem te këto kontrata që janë të inkuorporuara në drejtori të ndryshme. Konkretisht e ceku edhe kolegu im te shërbimet për realizimin e infrastrukturës për funksionalizimin e projektit shtretër shtëpiak. Pikërisht ne raportin e auditorit ka pasur te gjetura që ne këtë lloje zëri ne lidhje me këtë lloj kontrate me shërbime te caktuara ka gjetur dyshime lidhur me keqpërdorimin e parasë publike edhe ne i kërkojmë drejtorit te shëndetësisë publike duke pasur parasysh shumën 378,000 euro që është një shumë jashtëzakonisht e madhe që me na sjellë raporte në baza mujore drejtorit të shëndetësisë, për arsye se aty është dyshime që bëhet keqpërdorim i parasë publike. Do të lidhem që nuk është komuna e konkretisht kryetari që ka bërë një lloj informimi qytetareve të komunës lidhur me këtë shërbim. Unë me dy raste i kam që kanë qenë pacientë me stade finale ku kanë kërkuar shërbime edhe në kuadër të QKMF-së dhe nuk ju kanë ofrue shërbime dhe kjo është për me te ardhë keq edhe sigurisht që qytetaret duhet me ditë për këtë shërbim se nuk i pranon Prishtina për arsye se janë stad final e nuk i pranon Rahoveci me i krye një shërbim pasi ka pasur kancer maksillofacial dhe nuk kanë pas guxim dhe punën që ju obligon ligji me pastrua një plagë në kuadër te QKMF-së e në të njëjtën kohë jepen para për këtë lloj shërbimi. Pra, këtë drejtori i shëndetësisë dhe Kryetari duhet me pas parasysh pasi ne vazhdimisht kemi kërkuar për këtë shume e aq me pas që e njëjta kompani i ka marr mbi 20 tender për shuma 60,000 apo 70,000 që shifra për të njëjtën kompani shkon mbi 1 milion euro. Pastaj, hartimi i strategjisë për zhvillimin lokal për komunën e Rahovecit 17,000 euro, nuk e di se për çfarë strategjie bëhet fjalë që kish pas mundësi me na shtjellua dhe me na shpjegua këtë shume te parave dhe tjetra që nuk po e kuptoj është mbikëqyrja e investimeve kapitale pasi nuk e di a është kompani private që e bën këtë mbikëqyrje apo duhet me shkua në drejtori përkatëse të cilat e kanë përgjegjësi që ato investime që janë në secilin drejtori që ato me i mbikëqyr.

Afrim Limani – Faleminderit për pyetjet, unë do të mundohem me ju dhanë përgjigje. Pyetjen e parë e parashtroj z. Fazliu pasi ka dallim ne mes te hyrave te planifikuara dhe atyre te realizuara dhe përmendi një shembull që ne vitet tjera që kam qenë edhe pjesë e juaja vazhdimisht dhe e kam ngritë këtë çështje, që me te vërtet e kemi pasur një planifikim te madhe ne krahasim me planifikimin real që e ka komuna e Rahovecit. Unë e konsideroj edhe shembulli me i mirë që si komunë mundemi me arrit edhe me shume të hyra ne raport me planifikimin që e kemi real. Ne si drejtori e financave kemi adresuar kërkesa ne kuader te Ministrisë se Financave që është rast precedent me komuna tjera pasi te gjitha kërkojnë me zvogëluar kurse na me rritë mirpo nuk e kanë marr parasysh këtë kërkesë dhe shpresoj që këtë vitë po, që planifikimi real është me tepër se 180,000 euro dhe shembull me te mirë e kemi te kalimi i të hyrave që e kemi bërë edhe sivjet. Gjithashtu shpresoj që për planifikimin e buxhetit për vitin 2022 te jetë një planifikim shume real. Pastaj Gjjobat e gjykatave dhe gjjobat e trafikut përafërsisht nuk ka ndonjë dallim shume i madhe dhe ne e dimë te gjithë se këto të hyra janë te pandikuara dhe trajtohen si te hyra të jashtëzakonshme. Gjithashtu fat i mirë ë sivjet ka pasur të hyra të mira ne kuadër te gjjobave ne trafik 204,000 euro dhe paramendohe atë shume me investue ne kuadër te një projekti kapital. Pastaj taksa për legalizimin te objekteve, këtë kategori te hyrave e kemi rregulluar përmes programit që kemi në softwer por dallimi është prape kemi telashe ne kuadër te drejtorisë se administratës p.sh. certifikatat e lindjes shkojnë në kuadër te një kategorie tjetër edhe sigurisht që ka mospërputhje dhe krejt këto janë gabime ne program ne softwer që na nuk kemi çasje aty. Pastaj te shfrytëzimi i pronës publike janë disa pjesë te parcelave që na i japim me qera, pra siç e thash edhe ne fillim se jemi treguar me tolerant kësaj here edhe nuk kemi bërë presion te qytetaret edhe kjo ka ndikuar që të jete edhe një

inkasim me i vogël. Po ashtu te participimet ne bujqësi kemi pasur problem që me planifikua që me bo planifikim real edhe përafërsisht jemi munduar por duke ditur si shkon procesi dhe dinamika e zhvillimeve dhe investimet që do të bëhen jo krejt brenda një viti por ndoshta edhe vitin tjetër dhe për këtë e kemi bërë një ndarje ne dy vite. Pastaj pyetja tjetër ishte rreth krahasimit të rritjes se shpenzimeve në kuadër te mallrave dhe shërbimeve ne krahasim me dy vite dhe siç e thash edhe ne fillim se kemi arrit që buxhetin ta shpenzojmë ne atë përqindje dhe kjo ka reflektue indirekt që nuk kemi pare ne suficit dhe te gjitha paret që i kemi pasur i kemi shpenzuar dhe kjo ka ndikuar që te rriten shpenzimet e buxhetit ne kuadër te mallrave dhe shërbimeve ne krahasim me vitin 2019. Te furnizimi pastrimi gjithashtu edhe kjo pyetje ndërlidhet me ato sepse kemi arrit me i krye te gjitha obligimet ne kuadër te kësaj kategorie dhe për atë te furnizimi i pastrimit kompanitë që i kemi te kontraktuara dhe e dimë që janë 2-3 kompani që bëjnë pastrimin e rrugëve gjatë dy sezoneve pastaj kompanitë që merren me pastrimin e parqeve banesave. Pra krejt këto kanë ndikuar që ne e kemi rritë edhe obligimet. Gjithashtu edhe te mirëmbajtja e objekteve shëndetësore, dallimi qëndron se ne vitin 2019 nuk kemi mundur me arrite deri ne muajin e peste apo te gjashtë me kontraktue një kompani edhe shpenzimet i kemi krye në forma tjera edhe ne momentin që kemi arrit kontratën ne vitin 2019 e kemi raportin edhe këtë vite kontrata me atë kompani ka filluar që nga Janari edhe këtu është dallimi në kuadër te asaj. Vlera e madhe e buxhetit për hartimin në kuadër te një projekti për hartimin e një projekti mbi 350,000 pasi kontrata ka skaduar dhe ne jemi detyruar me rintenderue edhe njëherë një projekt ne mënyrë që të mos lidhim kontrata te shpeshta dhe atëherë e kemi kontraktua këtë kompani me këtë vlerë d.m.th. me afate afërsisht 3 vjeçare edhe shpenzimi i buxhetit këtu varet ne sasi, po supozojmë e ka hartue një projekt ehe vlera e atij projekti është me shume te caktuar dhe jo me afat kohor. E dimë që me vlerën 350,000 duhet me u hartue një numër i madhe projekteve edhe unë e konsideroj që nëse e përpjesëtojmë ne 3 vite atëherë kjo shume është përafërsisht reale. Pastaj pyetja e parashtruae për ofrimin e shërbimeve mjekësore shtretër shtëpiak, në kuadër te këtij projekti e kemi pasur si te gjetur dhe per kete jeni dëshmitar edhe ju pasi dy vite e kemi pasur si te gjetur si dhe rekomandim, dhe konsideroj që kete vite i kemi marr te gjitha masat dhe veprimet e nevojshme që edhe ky projekt te mos del edhe njëherë si rekomandim sepse jo që ishte ndonjë rekomandim i madhe por kryesisht është i ndërlidhur ne disa procedura ne tepër teknike te cilat edhe ne nuk kemi pasur njohuri që duhet zbatua edhe besoj që brenda këtij viti do te jemi ne rregull edhe ne kuadër te këtij projekti dhe shpenzimi është i lartë sepse numri i madhe i punëtorëve është i madhe dhe gjithashtu edhe ne raport e kemi se sa është shpenzimi për këtë pasi raporti është publik që vetëm për shtretër është afërsisht 200,000 euro. Po ashtu pyetjet që i parashtrij doktori janë përafërsisht te njëjta me z. Fazliu që ka marr përgjigjen dhe vetëm te Ali Zhuniqi e ndiej për obligim që te ja jap një përgjigje. Pasi raporti i zyrës se Prokurimit sigurisht që ata janë përgjegjës mirëpo mua me takon që te marr përgjegjësin këtu dhe siç e potencova strategjia e zhvillimit ekonomik te Komunës. Fatkeqësisht komuna e Rahovecit ende nuk ka një plan strategjik për zhvillimin e ekonomik edhe te them te drejtën jemi vonuar shume dhe pikërisht për këtë ne raportet e performances ne do te humbim shume poena edhe sigurisht që humbim edhe shumë para. Pikërisht për këtë jemi detyruar që jasht planit te prokurimit ta shpallim ka muaji dhjetor dhe pikërisht për shkak te performances jemi detyruar sepse plani ka qenë ne kuadër te vitit 2021 kështu që jemi detyruar ta shpejtojmë procedurat dhe ta shpallim këtë projekt ne mënyre që ne vitin 2021 te dalim edhe me një performancë me te mirë. Edhe realisht çdo komunë duhet ta ketë planin zhvillimor komunal ekonomik që realisht ne jemi vonuar shume ne këtë proces. Gjithashtu une konsideroj se vlera nuk është e lartë sepse çdo komunë e bënë planin zhvillimor ekonomik me afat 4 vjeçar mirpo ne do ta bëjmë ne afat prej 5 viteve. Ndoshta edhe kjo që ka një dallim ne vlerë por megjithatë prap konsideroj që çmimi dhe vlera e kontratës është e arsyeshme ne raport me punët te cilët priten te kryhen.

Kryesuesi – Faleminderit shume drejtor për te gjitha sqarimet, kalojmë në pikën e pestë te rendit te ditës:

4. Informatë rreth punës së KKSB-së për gjashtë (6) mbledhjet e vitit 2020.

Kryesuesi – E kemi materialin e informatës rreth punës së KKSB-së edhe mendoj që të gjithë e kemi lexuar dhe e kemi parë pasi janë plotësuar kushtet dhe kriteret e kryetarit i cili e udhëheq KKSB-në që ka mbajtur 6 takime të rregullta për vitin 2020, ku në takime kanë marr pjesë komandanti i Policisë, pjesëtarët e KFOR-it dhe janë të përshkruar shumë mirë të gjitha aktivitetet që janë kryer gjatë vitit 2020 si dhe janë paraqitur edhe pjesa e pandemisë ku jemi përballur të gjithë me një situatë të tillë. Atëherë më që nuk ka dikush diçka rreth pikës së pestë, kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës.

Kryesuesi – Gjithashtu edhe për këtë pikë, kjo rregullore ka qenë në muajin nëntor me të cilin e ka marrë aprovimin e kuvendit që të del në debat publik dhe i ka kryer të gjitha procedurat dhe kriteret për përmbushjen e kësaj rregullore, kështu që e kemi pasur edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe i kemi rekomanduar kuvendit që të aprovohet kjo rregullore. Gjithashtu kemi pritur të gjitha komentet që kanë ardhur nga shoqëria civile ne si kuvendarë. Kështu që nese nuk ka dikush diçka sa i takon pikes se gjashtë te rendit te ditës, atëher e qesim ne votim. Konstatohet se unanimisht aprovohet pika e gjashtë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik të parcelës P- 71510066 – 00386-1

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkryetar, anëtarë të kuvendit. Para jush keni vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm P – 00386-1 në zonën kadastrale në Pastasel. Kjo është pronë shtetërore e Kosovës që është në menaxhimin të agjencionit pyjor të Kosovës që pas një kerkese nga Këshilli i fshatit kanë kërkuar prej neve që ndajnë një parcelë me sipërfaqe prej 10 ari ku po planifikohet të ndërtohet një objekt që do të i shërbejë komunitetit të fshatit për aktivitete të ndryshme. Ftoj anëtarët e kuvendit që pas shqyrtimit të votojnë propozimin e vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, atëherë nëse nuk ka dikush diçka rreth kësaj pike, atëherë e qesim në votim pikën e shtatë të rendit të ditës. Konstatohet se unanimisht aprovohet pika e shtatë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e tetë të rendit të ditës:

7. Raporti i Punës së këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2020.

Kryesuesi – Gjithashtu për këtë pikë kemi një informatë që na ka ardhë prej kryetarit z. Pavloviç mirëpo për momentin nuk gjendet këtu dhe ne e kemi lexuar materialin rreth punës që e kanë krye këshilli i fshatit Hoçë e Madhe. Të nderuar kolegë ju faleminderit shumë për kontributin tuaj dhe shihemi në mbledhjen e radhës.

01 Nr.168/21

Datë:26.02.2021

Proqesmbajtësi:

Agim Hoti

